



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.09.2016, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Vazhdimi i diskutimit të projektligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Spartak Braho, Keltis Kruja, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Aldo Bumçi.

Mungojnë: Spartak Braho, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Gent Ibrahimimi – Ekspert i Nivelit të Lartë

Rainer Deville - Ekspert i Nivelit të Lartë

Agnes Bernhard - Ekspert i Nivelit të Lartë

HAPET MBELDHJA

Fatmir Xhafaj – Përshëndetje!

Hapim mbledhjen e Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë.

Në rendin e ditës kemi vazhdimin e shqyrtimit të projektligjit “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”. Ditën e premte kemi bërë një paraqitje të ndryshimeve, ose më saktë të reflektimeve që janë gjykuar, të bëhen nga grupi i ekspertëve, mbështetur në ndryshimet kushtetuese po që po, por edhe në debatet që janë bërë në komision paraprakisht në disa sugjerime, propozime që ka bërë relatorja, zonja Hysi dhe kolegu Vasili. Ekspertët, zoti Ibrahim, informoi lidhur me reflektimet përkatëse që kanë bërë dhe që ata e çmojnë të nevojshme për t’u reflektuar gjatë debatit që do të bëhet në proces.

Gjithashtu, edhe zonja Hysi parashtroi në mënyrë të shkurtuar bashkë me zotin Vasili se cilat ishin propozimet, sugjerimet që ata kishin për ta përmirësuar më tej projektin. Sot kemi marrë një opinion të grupit të deputetëve të Partisë Demokratike nga zoti Bylykbashi rreth projektligjit. Besoj se zoti Bylykbashi do të bëjë një paraqitje të projektit dhe pastaj do të fillojmë shqyrtimin nen për nen.

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, ky është një nga ligjet më të rëndësishme që ne duhet të kalojmë si komision dhe që rrënjën duhet ta gjejë 100% në Kushtetutë. Sigurisht që ky ligj nuk ka se si të mos reflektojë arkitekturën komplekse dhe problematike të sistemit. Kjo është ajo që kemi, përfshirë këshillin e emërimeve në drejtësi që sot është praktikisht një organ i cinguar në funksionin e tij. Në opinionin që kemi paraqitur sot para jush ai është i përbërë nga dy aspekte. Njëri është komentet që bëhen për dispozitat në një këndvështrim të përgjithshëm, si çështje principale, dhe më pas janë konsiderata nen për nen. Në nenet e rëndësishme që u korrespondojnë 9 çështjeve kryesore janë paraqitur dhe amendamente të cilat janë në një version të shkëputur nga teksti i opinionit.

Unë do të bëj një prezantim të shkurtër të çështjeve kryesore dhe më pas në diskutimin nen për nen, kryesisht aty ku janë çështjet që ne mendojmë se duhet patjetër komisioni t’i marrë në konsideratë amendamentet, do të ndalem në mënyrë më të

detajuar. Ndërsa çështje me karakter më teknik te vërejtjet që kemi bërë, ne gjykojmë që është e domosdoshme që të merret në konsideratë nga ekspertët dhe nga ky komision, në mënyrë që ligji të jetë i saktë.

Ajo që ne do të ngulim këmbë janë çështjet principiale që kanë të bëjnë me antikushtetshmëri të tekstit që është paraqitur para këtij komisioni. Sigurisht edhe pse formalisht është një projektligj i paraqitur nga deputetë, ndërkohë që këtu paraqitet nga ekspertët, është një projektligj që qartazi është punuar në pjesë të shkëputura dhe ka një mungesë koherence teknikisht edhe kur e lexon.

Por nuk është kjo çështja thelbësore, për sa na përket neve. Një ligj i hartuar me probleme dhe kundërshti brenda edhe teknikisht, sigurisht që mund të përbëjë një problem sipas Gjykatës Kushtetuese, edhe problem edhe kushtetues. Ne do të ndalemi te çështjet thelbësore ku haptazi ky projektligj jo thjesht shkel Kushtetutën, por ka cenuar marrëveshjen politike dhe konsensusin e datës 21 korrik duke e zhbërë pikërisht atë konsensus i cili çoi në miratimin e dispozitave kushtetuese në datën 22 korrik. Sigurisht kjo që ne shohim sot është pasojë e thyerjes së një marrëveshjeje politike e cila është nënvizuar edhe këtu në këtë komision. Kemi rënë të gjithë dakord muaj më përpara që Kushtetuta dhe 7 ligjet do të miratoheshin bashkë për arsye të zbardhja e këtyre ligjeve organike dhe e testit kushtetues do të ishte e saktë dhe konsensuale. Sigurisht ajo që ne vendosëm, që të mbështesim miratimin e Kushtetutës në mirëbesimin që do të vazhdohej me konsensus, sot është përsëri prova, por kjo është prova më e madhe ndoshta pas ligjit të vetingut që vërteton se ajo marrëveshje është thyer, ai konsensusi i 21 korrikut është thyer. Kjo në mënyrë jo vetëm duke shkelur frymën e dispozitave kushtetuese, por dhe germën e dispozitave kushtetuese. Sigurisht në çështje të veçanta do të kërkojmë dhe një opinion të ekspertëve që janë sot këtu për ta mbrojtur këtë draft përpara këtij komisioni.

Tani unë po futem te çështjet kryesore. Çështja kryesore, ajo që shkon më haptas, drejtpërdrejt, ballazi, përplasjet me Kushtetutën, me konsensusin e 21 korrikut, është çështja që deformon. Pra, deformimi që i është bërë asaj që parashikohet në Kushtetutë si kompetencë e Kuvendit në zgjedhjen e anëtarëve, jo gjyqtarë dhe jo prokurorë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Kushtetuta e ka parashikuar si një kompetencë të Kuvendit pa asnjë lloj bashkëpunimi me organet e

tjera. Kjo është ajo që është miratuar në datën 22 korrik mbi bazën e marrëveshjes politike me negocimin e faktorit ndërkombëtar në datën 21 korrik. Në Kushtetutë, ndryshe nga çfarë parashikohej në draftin e parafundit, është sanksionuar që konkurrimi i shtetasve shqiptarë, të cilët kanë kritere profesionale të përcaktuara nga Kushtetuta, është i lirë dhe i hapur jo vetëm transparent, por i lirë dhe i hapur për secilin person i cili përmbush kushtet. Pra, të gjithë avokatët e Republikës së Shqipërisë që përmbushin kushtet kanë të drejtë të konkurrojnë të papenguar pranë Kuvendit të Shqipërisë. Dhe procesi i përzgjedhjes së tyre ndodh në Kuvendin e Shqipërisë. Të gjithë pedagogët e së drejtës të të gjitha fakulteteve të drejtësisë në Shqipëri kanë të drejtë të konkurrojnë të lirë dhe të papenguar pranë Kuvendit të Shqipërisë dhe të përzgjidhen nga Kuvendi pa asnjë lloj filtri.

Po kështu shoqëria civile, të gjithë eksponentët e shoqërisë civile që mendojnë se përputhin kushtet konkurrojnë të lirë. Këtë parashikon Kushtetuta bazuar dhe mbi të drejtën e të shtetasve shqiptarë për të konkurruar për funksione publike në Republikën e Shqipërisë, një e drejtë themelore kjo dhe e pafiltruar nga asnjë prej organeve vetërregulluese, siç ishte parashikuar më parë. Është një marrëveshje politike në themel të konsensusit të datës 21 korrik. Mbi të gjitha e sanksionuar qartas kështu në Kushtetutë. Dispozita e vjetër që parashikonte Dhomën e Avokatisë si një filtër paraprak u hoq.

Po kështu Kushtetuta nuk parashikon asnjë organ të sajuar si mbledhja e përbashkët e drejtuesve të fakulteteve të drejtësisë, një sajese kjo që as në Kushtetutë nuk është, madje nuk përmendet dhe është një gjë tërësisht e krijuar për të filtruar dhe për të kontrolluar procesin. Aq larg ka shkuar e gjithë kjo sa për shoqërinë civile është krijuar dhe kjo diskrepancë, se shoqëria civile, e vetmja, ka të drejtë për të konkurruar e lirë, e papenguar në Kuvend. Ndërkohë që avokatët dhe pedagogët e të drejtës filtrohen. Është shkelje e frymës dhe e germës së Kushtetutës. Janë krijuar organe që nuk ekzistojnë, janë parashikuar organe që nuk i parashikon Kushtetuta.

Mbi të gjitha është e cenuar e drejta e Kuvendit për të qenë organi i vetëm që ka të drejtën për ta hapur dhe për ta mbyllur këtë proces, duke e vënë atë në bashkëpunim me këto instrumente të tjerë filtrimi të qëllimshëm që kanë vetëm një synim, kapjen e procesit dhe të kandidaturave që do të shkojnë në Kuvend. Pikërisht këtë zhbëri marrëveshja politike e datës 21 korrik. Pikërisht kjo u sanksionua në Kushtetutë në

tekstin final. Pra, kjo është një shkelje haptas jo vetëm e frymës, por dhe e germës që bie ndesh me nenin 147 të Kushtetutës, por dhe në nene të tjera, përshirë nenet 4 dhe 116 të Kushtetutës. Dhe politikisht ky komision dhe kushdo që e ka propozuar, apo e mbrojnë atë është duke e kapërcyer Kushtetutën në mënyrë flagrante.

2. Kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të prokurorisë, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe inspektorët e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë janë minimaliste dhe nuk sigurojnë kriterin kushtetues të përzgjedhjes së kandidatëve me integritet të lartë moral dhe profesional. Sigurisht e bërë në këtë mënyrë, ndryshe nga çfarë parashikon Kushtetuta, dhe çfarë kërkon Kushtetuta, kjo bën që të mos kemi mundësinë që të respektojmë këtë kërkesë kushtetuese dhe në këto organe të shkojnë persona të cilët nuk duhet të jenë në këto organe.

3. Rregullimi i të gjitha aspekteve të organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk mund të përcaktohen nëpërmjet përdorimit të shprehjes se rregullat zbatohen për aq sa është e mundur dhe me ndryshimet përkatëse.

Do të vijmë te neni përkatës, madje te kreu përkatës që mbyllet në një nen në lidhje me Këshillin e Lartë të Prokurorisë i cili është ekzemplar në praktikën legjislative të parlamentit të Shqipërisë. Është midis përtesës për të bërë punën dhe një formulimi i cili haptas krijon një konfuzion në zbatimin e një ligji kaq të rëndësishëm dhe nesër mund të cenohet themelet e parimeve të shtetit të së drejtës, përfshirë këtu sigurinë juridike. Sepse ky organ mund të arrijë deri aty sa të ketë diskrecion për të vendosur në lidhje me zbatimin e rregullave të parashikuara në pjesë të tjera të legjislacionit. Kjo është e papranueshme dhe sigurisht për sa kohë mbetet kështu është një bazë e fortë për ta bërë antikushtetues këtë pjesë të rëndësishme që rregullon Këshillin e Lartë të Prokurorisë në këtë ligj.

4. Rregullat mbi statusin e inspektorit të Lartë të Drejtësisë duhet të jenë në përputhje me paragrafin 5 të nenit 147/d të Kushtetutës ku specifikohet se Inspektori i Lartë i Drejtësisë gëzon statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Nga ana tjetër dhe rregulli mbi deklarimin e mbarimit të mandatit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë bie ndesh me pikën 2 të nenit 147/dh të Kushtetutës ku sanksionohet se deklarimi i mbarimit të mandatit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë bëhet me vendim të mbledhjes së

përbashkët të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ndërkohë që projektligji këtë kompetencë ia njeh Kuvendit. Është pikëpyetje e madhe se si ka mundësi që ky projektligj ka kaluar edhe filtrin e ekspertizës për të ardhur në një kundërshti të këtillë kushtetuese përpara këtij komisioni. Sigurisht jemi përpara një përplasjeje të drejtpërdrejtë dhe shmangie të një kompetence siç i njihet të tjera organeve duke ia kaluar një organi tjetër.

5. Rregullat mbi fillimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi bien ndesh me paragrafin 3 të nenit 149/d të Kushtetutës ku specifikohet se ata ushtrojnë detyrën me një mandat 1-vjeçar që fillon në datën 1 janar të çdo viti kalendarik. Sigurisht Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nga guri i qemerit, i arkitekturës, që ishte parashikuar më parë, që praktikisht çonte në kapjen e të gjithë sistemit, sot ka përfunduar në një organ gjysmak me shumë pak kompetencë dhe me gjithë përpjekjet antikushtetuese për të dhënë kompetenca që nuk mund t'i ketë, jo nuk duhet t'i ketë në çdo rast së paku këto formulime që janë eksplicite në Kushtetutë nuk mund të anashkalohen ose tejkalohen nga ligji.

6. Projektligji përmban rregulla për shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve, prokurorëve dhe anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese që bie ndesh me nenet 128-140 me nenin 148/d të Kushtetutës. Kjo për faktin se projektligji i njeh të drejtën Këshillit të Emërimeve në Drejtësi që të shkarkojë nga detyra një gjyqtar, prokuror apo anëtar të Gjykatës Kushtetuese që njëkohësisht është anëtari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Kryerja nga një anëtar i KED-së në një shkelje disiplinore, sipas nenit 153 të ligjit, mund ta sjellë automatikisht shkarkimin e tij nga detyra e anëtarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, por nuk mundet pa sjellë automatikisht shkarkimin si gjyqtar apo si prokuror, sepse kjo është një kompetencë që është parashikuar nga Kushtetuta për Këshillin e Lartë Gjyqësor, apo Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Në të njëjtën mënyrë vendos edhe Gjykata Kushtetuese për shkarkimin e një anëtari të saj. Pra, nuk mund të jetë kompetencë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Sigurisht që duhet ta kuptojmë mirë dhe kur të jemi në diskutimin nen për nen do të shohim se kush do të jetë dhe opinionin e ekspertëve, pse kanë shkuar kaq larg me diçka që nuk ka ndodhur kurrë në legjislacionin shqiptar.

7. Parashikimi nga ky ligj i rregullave mbi organizimin dhe funksionimin e Shkollës së Magjistraturës bie ndesh me gërmen "a" të pikës 2 të nenit 81 të Kushtetutës

për shkak se Shkolla e Magjistraturës nuk është as institucion kushtetues, dhe as institucioni i parashikuar nga Kushtetuta. Është thjesht vetëm institucion i përmendur nga Kushtetuta dhe këto të tria janë kategori të cilat janë të përcaktuara në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë kuptim rregullat e organizimit dhe të funksionimit të saj përcaktohen nëpërmjet një ligji të miratuar me shumicë të thjeshtë të votave në Kuvend dhe jo nga një ligj i miratuar me shumicë të cilësuar, siç është ligji që diskutojmë sot. Organ, për shembull, i përmendur nga Kushtetuta, por nuk është as organ kushtetues, as i parashikuar nga Kushtetuta, është Shërbimi Informativ Shtetëror, është shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura. Përmenden nga Kushtetuta, por nuk janë as organe kushtetuese, as të përcaktuara nga Kushtetuta. Për shembull, siç e dini shumë mirë, në të dyja rastet që përmenda rregullohen me ligj të thjeshtë. Po kështu dhe Shkolla e Magjistraturës. Për këtë arsye dhe sot e kësaj dite është me një ligj të thjeshtë dhe, për rrjedhojë, tentativa për ta futur një ligj me shumicë të cilësuar ka dy qëllime:

a. Për të krijuar një situatë të caktuar me interes politik.

b. Mbi të gjitha problemi kryesor është që kjo shkon në kundërshtim me Kushtetutën.

Cilat janë ligjet që duhet të miratohen me shumicë të cilësuar? I ka përcaktuar Kushtetuta, ky nuk është një nga ato, ose rasti i Shkollës së Magjistraturës.

8. Projektligji nuk parashikon detyrimin që anëtarët e jashtëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor apo Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë t'i nënshtrohen procesit të detyrueshëm të rivlerësimit të aftësive të vetingut, aftësive profesionale, ligjshmërisë së pasurisë dhe pastërtisë së figurës para fillimit të tyre. Pra, anëtarët e jashtëm jo gjyqtarë dhe jo prokurorë dhe rasti i inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Arsyeja është se akoma nuk e kuptojmë dot. Për sa kohë një sistem kaq i rëndësishëm po kalon i tëri në filtrin e vetingut nuk është e qartë se cili është qëllimi që këta funksionarë të mos u nënshtrohen kësaj.

9. Projektligji përmban parashikime që janë të papranueshme për statusin dhe pozitën kushtetuese të Presidentit të Republikës, por bie ndesh dhe me nenin 179 të Kushtetutës. Kushtetuta ka parashikuar se është Presidenti i Republikës që zgjedh me short anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, nenet 149/d, 179 pika 11, ndërsa Avokati i Popullit thjesht ka të drejtë të marrë pjesë si vëzhgues në procesin e hedhjes së

shortit. Ndërkohë ligji parashikon që shorti zhvillohet në zyrën e Avokatit të Popullit dhe unë besoj, të gjithë ne besojmë, madje edhe ju brenda ndërgjegjes tuaj e kuptoni shumë qartë se është alogjike që një kompetencë, që është parashikuar ta kryejë Presidentin e Republikës, Presidenti do të shkojë ta kryejë këtë të Avokati i Popullit. Ne nuk mund të sillemi në këtë formë me organet kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

10. Në fakt kjo pikë është e përgjithshme, e kemi thënë dhe më parë. Ka një numër komentesh që kemi bërë dhe në këtë komision. Është përmbajtje në tërësi e projektligjit, paraqet disa çështje që vlerësojmë se janë hartuar në mënyrë të paqartë dhe në kundërshtim me teknikën e hartimit të ligjeve çka mund të krijojë probleme gjatë zbatimit. E kemi ngritur rregullisht, problem i cili është në të gjithë ligjet e shqyrtuara deri më sot. Ne jemi përpjekur të japim maksimalisht për këtë gjë, sepse siç e kemi thënë edhe konfuzioni në legjislacion, përplasja e dispozitave apo e ligjeve me njëri-tjetrin mund të përbëjë bazë antikushtetushmërie, për rrjedhojë ndërhyrje nga Gjykata Kushtetuese, gjë që nuk na leverdis në një proces kaq të rëndësishëm.

Këto ishin çështjet me karakter të përgjithshëm. Janë të gjitha, por te disa prej tyre, me një gravitet shumë të madh, haptazi shkelet konsensusi politik, ai që mbajti Kushtetutën më datë 22 korrik dhe përplasen ballas me nenet si në germë dhe në frymë. Sigurisht detyra jonë është që nenet e Kushtetutës t'i zbërthejmë në mënyrën më të saktë dhe do të ishte fatale nëse qasja e këtij komisioni përtej instrumenteve për të siguruar maxhorancën tuaj në këtë komision të jetë e tillë. Ne Kushtetutën e interpretojmë në këtë formë, nuk ka rëndësi se si. Nuk mund të ketë sistem që t'i bëjë ballë një keqbesimi të këtillë në një proces kaq të rëndësishëm. Është një ligj i cili nëse nuk bëhet mirë do të na japë probleme në funksionim, aq më tepër kur shkeljet kushtetuese janë kaq flagrante dhe kaq të shumta. Sigurisht që kjo do të çojë në kolaps të procesit. Këto janë komentet e përgjithshme. Në diskutimin për dispozita konkrete do të bëj ndërhyrjet e veçanta.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit për parashtresën, pavarësisht se ndajmë pikëpamje krejt të ndryshme për një sërë çështjesh, ashtu siç mendoj që ka vend për disa të tjera për t'u marrë në konsideratë dhe për t'u reflektuar. Këto janë këndvështrimet reciproke. Ajo që dëshiroja të mos ishte përmendur shpesh në fjalën tuaj është një lloj kërcënimi politik që do të shkojë në Gjykatën Kushtetuese. Kjo është normale, nuk ka asgjë të keqe, është e drejta juaj kushtetuese. Ushtrojeni të drejtën dhe nuk ka asnjë

problem. E keni thënë për të gjitha ligjet deri tani. Gjykata Kushtetuese prandaj është aty. Ju mund të çoni të gjitha projektligjet në Gjykatën Kushtetuese, siç e keni thënë që ditën e parë. Mendoj se do t'ia kursejmë vetes së paku sa jemi në fillimin e procesit, se ndoshta bindemi reciprokisht se për çfarë po flasim. E para.

E dyta, e dëgjova shpesh frazën që teksti ka probleme, nuk ka koherencë, kjo mund të jetë antikushtetuese, por neve nuk na intereson. Në qoftë se nuk ju intereson pse jeni këtu? Besoj se ju intereson që ta përmirësojmë. Ju duhet të kuptoni që jo çdo gjë që thoni ju do të bëhet ashtu siç thoni ju. Ashtu siç dhe ne nuk kemi pretenduar me çdo gjë që kemi thënë, apo kemi trajtuar, do të bëhet ashtu siç themi ne. Kjo është normale. Midis palëve është një debat këndvështrimesh. E rëndësishme është që të bëhet më e mira. Në vlerësimin tim, për shembull, nuk ka asnjë element që mund të jetë në kundërshtim me Kushtetutën e miratuar as në kundërshtim me konsensusin e miratuar. Përkundrazi, projekti i paraqitur e ruan më së miri atë çfarë është arritur konsensualisht dhe konsensualisht quaj atë që është në dokumentin kushtetues. Nuk ka cenim të normës kushtetuese. Ky është konsensusi. Nga ajo datë nuk është më konsensusi ai që udhëheq procesin, por Kushtetuta që udhëheq procesin. Është gjë shumë e mirë që kemi pasur konsensus për atë Kushtetutë, por është një gjë akoma më e mirë që të respektojmë Kushtetutën ashtu siç është dhe ashtu siç e lexojmë, siç duhet lexuar, me gjuhë kushtetuese. Ka gjëra që nuk biem dakord, prandaj i kemi dhe ekspertët për t'i dëgjuar.

Por paraprakisht, në vlerësimin tim, po e them se nuk ka asnjë dispozitë që është në kundërshtim me germën e Kushtetutës. Konsensusi është i materializuar tek ato germa. Ne kemi për detyrë ta respektojmë duke respektuar germën e Kushtetutës. Nëse do të bëjmë ndonjë gabim do ta çoni në Gjykatën Kushtetuese siç thoni ju. Le ta vendosë Gjykata Kushtetuese, nuk është hera e parë që vendos kjo gjykatë për gjëra që kemi vendosur ne dhe ka thënë që nuk keni të drejtë. Siç nuk është hera e parë kur keni shkuar ju në Gjykatën Kushtetuese dhe ju ka thënë që keni bërë gabim që keni ardhur në Gjykatën Kushtetuese. Ky është një proces ligjor, kushtetues, prandaj ne jemi këtu që ta respektojmë edhe këtë që bëjmë, edhe atë që mund të ndodhë nesër në vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Nuk është herezi po të ketë. Në vlerësimin tim nuk ka asgjë në kundërshtim me germën dhe frymën e Kushtetutës.

Dhe meqenëse më thoni me Komisionin e Venecias kam një arsye më shumë për të thënë që ky është akoma më shumë një zgjidhje konform Komisionit të Venecias. Por le të mos humbasim kohë me deklarata të përgjithshme. Le të fillojmë nen për nen dhe ku ka nevojë le ta debatojmë.

Arben Ristani – Unë kam një gjë të vogël.

Fatmir Xhafaj – Unë thashë të vazhdonim nen për nen.

Arben Ristani – Vazhdojmë nen për nen, por ka një problem nga mënyra se si do të përfaqsohem ndaj gjësë. Parashtrimi që bëri kolegu Bylykbashi tregon për një punë që ne kemi bërë për ta parë nen për nen, për ta studiuar projektligjin, për të përgatitur vërejtjet tona të cilat i bëmë prezente. Sigurisht që është përmendur dhe harta e rrugës për të thënë që në rast se nuk gjejmë konsensus do të përdorim dhe mjete të tjera të cilat nuk janë ekskluzive tonat, sepse do t'i përdorin dhe institucionet që preken nga projektligji ose institucionet që mendojnë se projektligji shkon ndesh me dispozitat kushtetuese. E mira është që ne të vazhdojmë ta gjejmë konsensusin me njëri-tjetrin dhe të mos ndeshemi me arrogancën që është kështu, siç e thotë maxhoranca, dhe nuk ka ku shkon.

Pra, unë mendoj që parashtrësja juaj duke thënë se të gjitha vërejtjet që ne bëmë nuk qëndrojnë, sepse ju jeni të bindur që drafti është konform Kushtetutës, tregon për një orientim të debatit drejt arrogancës dhe refraktarizmit. Do të ishte e mirë që t'i marrim me qetësi gjërat, sepse vërejtjet sigurisht që janë të studiuara, nuk kemi asnjë nevojë të bëjmë debat për debat. Nuk jemi dhe ne këtu të harxhojmë kohë kot të bëjmë debat për debat. Jemi seriozë për punën që kemi bërë. E kemi studiuar projektligjin, kemi bërë vërejtjet. Le t'i shohim, i parashtruam. E mira është e diskutojmë mbi to. Por të thuash që nuk qëndron asnjëra që në dorë të parë, më duket pak e tepërt.

Fatmir Xhafaj - Zoti Ristani, nuk kam dëshirë të bëj shumë replika, sepse nuk është as në interesin e mbledhjes dhe drejtimit të saj. Ju thatë një gjë që nuk qëndron. Unë thashë krejt të kundërtën. Unë thashë që e kam parë, e ritheksoj me dashamirësi, pavarësisht se ishte sot herët në mëngjes, jam marrë gjithë paraditen vetëm me dokumentin tuaj. Është normale, sepse do të vinim në mbledhje. Unë në vlerësimin tim thashë se një pjesë e tyre janë çështje që meritojnë të diskutohen, të vlerësohen dhe të reflektohen. Unë thashë krejt të kundërtën e asaj. Madje nëse dëshironi ta dini më shqip, në mënyrë më eksplicite, nga 10 çështje vetëm 2-3 nga ato janë të diskutueshme dhe në

vlerësimin tim jo të pranueshme. Pjesa tjetër janë të gjitha çështje që meritojnë të diskutohen.

E gjitha kjo që më adresuat mendoj se ishte e gabuar. Nuk ishte kjo qasja ime. Përkundrazi, kam mbajtur të njëjtin qëndrim ashtu dhe maxhoranca dhe në ligjet e tjera ku ne kemi qenë të hapur për të diskutuar. Ne nuk mund biem dakord ndoshta për të gjitha çështjet dhe kjo nuk është ndonjë çudi e madhe. Nuk ka se si të jetë kështu që në gjithçka të jemi dakord. Ju përmendët shpeshherë që çështjen ta çonit në Gjykatë Kushtetuese. E vetnja vërejtje që ju thashë unë ishte sugjerimi. Ju çoheni në Gjykatën Kushtetuese, por mos e përdorni këtë si argument për t'u përballur. E para.

Dhe e dyta, unë kërkoja ndihmë që edhe për detajet teknike të kontribuonit për ta përmirësuar ligjin. Unë kërkoja ndihmë për këtë gjë. Unë ju thashë se pse thoni që nuk është çështja jonë? Është çështja jonë dhe ndihmoni që nëse ka detaje teknike, sado të vogla, t'i përmirësojmë siç i kemi marrë në konsideratë të ligjet e tjera. E njëjta gjë është dhe me zonjën Hysi kur ka sjellë ndërhyrjet. E ka lexuar ligjin dhe ka sjellë një sërë ndërhyrjesh. E ka lexuar ligjin zoti Vasili dhe ka thënë që për këto 7-8 pika nuk ndaj mendim ose mendoj që mund të reflektoj. Jam dakord me të tjerat, nuk jam dakord me këto dhe kërkoj të reflektohen. Në seancën e mëparshme u dha përgjigje pikërisht në sensin reflektues për këtë gjë. Por të mos keqkuptohemi për gjëra që nuk ka arsye të keqkuptohemi.

Faleminderit!

Vazhdojmë me nenin 1. Objekti.

Vasilika Hysi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Kanë kolegët ndonjë gjë? Dakord.

Neni 2. Parimet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë.

Vasilika Hysi – Dakord.

Fatmir Xhafaj - Ka gjë nga kolegët e tjerë? Nuk ka.

Neni 3. Përbërja e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe mandati i anëtarëve.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, kjo dispozitë ishte lënë e hapur në mbledhje, për shkak se do të reflektoheshin ndryshimet që u bënë në Kushtetutë. Ka përmirësime të projektit nga ana e ekspertëve. Pra, janë rregulluar disa gjëra. Unë kam disa sugjerime të

vogla për të qenë korrekte me formulimin e nenit 147 të Kushtetutës. Unë dua të biem dakord. Kur janë saktësime të teknikës legislative t'i lëmë dhe t'i bëjmë në mënyrë...

Fatmir Xhafaj – Besoj se biem dakord me këtë gjë që kur janë saktësime të teknikës, të gjuhës.

Vasilika Hysi – Shkallë, nivele të tilla...

Do të vijmë dhe te komenti juaj.

Fatmir Xhafaj – Zoti Bylykbashi, thotë që ne nuk na intereson çështja e detajeve teknike.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, po ndërhyj që të mos flasësh për mua pa folur unë. Komentet në lidhje me detaje të një karakteri teknik të rëndësishëm janë të bëra këtu, komente të karakterit të teknikës legislative. Meqë keni marrë përsipër që të bëni gjëra më të mëdha në kundërshtim me germën e Kushtetutës merrini përsipër t'i zgjidhni vetë.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Ju nuk doni të përfshiheni. Dakord, zonja Hysi.

Dakord me ndryshimet.

Neni 3.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, neni 3 është i lidhur drejtpërdrejt me çështjen e parë që ngritëm dhe për këtë ne kemi amendament. Komentet e detajuara i kemi bërë në opinion në paragrafin nr.1 të komenteve për dispozitat konkrete. Ne sugjerojmë që paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 3 të riformulohen me përmbajtjen siç është paraqitur. Nuk po e lexoj, sepse do të ketë nene të tjera që janë shumë më të detajuara, kjo për të mos humbur kohë, por dokumenti është i depozituar.

Përpara se të mbyllim diskutimin për këtë gjë do të doja opinionin e ekspertëve në lidhje me çështjen që ngremë ne në këtë çështje dhe propozimi që bëjmë. Më pas do të vazhdojmë diskutimin së bashku. Pra, paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 3 të riformulohen me përmbajtjen sipas propozimit tonë. Pyetja për ekspertët është: a konstatojnë shkeljen e germës dhe të frymës të dispozitës kushtetuese në momentin kur propozohet që Kuvendit të Shqipërisë t'i merret kompetenca ekskluzive që ka për t'ua dhënë organeve që nuk ekzistojnë në Kushtetutë? Madje përmenden edhe në ligj, por nuk janë as të përmendura nga Kushtetuta. Për rrjedhojë kjo krijon dy gjëra:

a. Marrjen e kompetencës së Kuvendit ose ndarjen me të tretë.

b. Ndikimin në procesin e kandidimit të hapur që parashikon Kushtetuta. Dhe më pas një opinion në lidhje me amendamentin e propozuar.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Ibrahim.

Gent Ibrahim - Faleminderit!

Natyrisht që ne nuk e shohim si shkelje të urdhërimit të Kushtetutës përderisa e kemi shkruar në këtë mënyrë. Këtë e kemi shkruar ne. Po ta kishim këtë dyshim nuk do ta kishim shkruar. Pse e kemi shkruar kështu? Ne nuk besojmë që cenojmë thelbin e urdhërimit të Kushtetutës i cili ia ka lënë Kuvendit të drejtën dhe detyrën për të përzgjedhur anëtarë të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Pse nuk ia cenojmë? Sepse në fund të fundit thirrjet për aplikime i bën Kuvendi, verifikimet për plotësimin e kushteve ligjore i bën Kuvendi, verifikimet për plotësimin e kriterëve etiko-profesionale i bën Kuvendi, zgjedhjen e bën Kuvendi. Ne bëjmë një interpretim qëllimor të dispozitës kushtetuese.

Ju mund të thoni që ju e dini më mirë qëllimin, sepse ju keni qenë të përfshirë në hartimin e kësaj dhe unë përpara kësaj nuk kam çfarë të them, por ama ne i referohemi qëllimeve të kësaj reforme që në ditën e parë, qëllime që janë të ngërthyera në dokumentet politike, strategjike të kësaj reforme. E kam fjalën për strategjinë e reformës në drejtësi, e cila ka kërkuar shumë qartë që të ketë një depolitizim të procesit, të përzgjedhjes dhe të emërimit të anëtarëve të qeverisjes së sistemit. Ne nuk besojmë se marrëveshja politike ka pasur për qëllim të mos respektojë objektivin strategjik të kësaj reforme, njërin nga objektivat strategjike të kësaj reforme, që është depolitizimi i procesit të përzgjedhjes. Ne thjesht ndihmojmë në realizimin e këtij objekti duke krijuar një proces përzgjedhës brenda grupeve të profesionistëve, sepse ne nuk i shohim këta në pozita pritëse në raport me qeverisjen e sistemit. Këta duhet të jenë aktorë me qeverisjen e sistemit. Këtë nuk e themi vetëm ne, por këtë e thotë edhe Komisioni i Venecias për të cilin të gjithë bashkë kemi rënë dakord për ta quajtur si arbitër. Komisioni thotë që në ndërtimin e institucioneve ka shumë rëndësi procesi i përzgjedhjes së anëtarëve, po aq sa ka rëndësi dhe mënyra e zgjedhjes së tyre. Ne përmes kësaj formule besojmë se nuk e cenojmë thelbin e urdhërimit kushtetues. Kompetencat janë që të gjitha të Kuvendit. Ne thjesht i mundësojmë Kuvendit të përzgjedhë në një grup kandidatësh të cilët janë përfaqësues.

A është ky cenim i së drejtës së kujtdo për të kandiduar? Jo, sepse të drejtën e kandidimit mund ta ushtrosh në disa nivele. Nuk është e thënë që të drejtën e kandidimit ta ushtrosh se s'bën te Kuvendi në mënyrë që të thuhet se nuk është cenuar ajo, për sa kohë që çdokush që përmbush kriteret ka të drejtën të kandidojë. Mund ta bëjë këtë para kolegëve të tij të cilët e përzgjedhin si përfaqësuesin e tyre më të mirë dhe që modestisht mund ta bëjnë këtë punë më mirë sesa Kuvendi. Kuvendi është një organizëm politik, do të veprojë i prirur nga interesat politike. Kjo është gjëja më normale në botë. Në përpiqemi të injektojmë një dozë profesionalizmi dhe përfaqësimi te ky grup njerëzish tek të cilët Kuvendi më pas do të vërë dorën dhe do të zgjedhë ata që preferon më shumë. Neve na duket e një rëndësie jetike që kjo zgjedhje e Kuvendit të bëhet midis më të mirëve dhe jo midis atyre që kanë kurajën më të madhe për të konkurruar ndonjëherë dhe pa justifikim etiko-profesional dhe midis atyre që kanë lidhje të shkurtra me politikën.

Në realitet mënyra se si shkon një mënyrë konkurrimi, kandidimi, e cila bëhet drejtpërdrejt në një organ politik, është që janë më të inkurajuar dhe më të prirur për të kandiduar njerëzit që kanë lidhje me politikën. Kjo mua më duket se bie ndesh me objektivin strategjik të reformës dhe ne këtu përpiqemi ta zgjidhim këtë problem. A jemi në kapërcim të urdhërimit kushtetues? Pa dyshim që ka një parim të madh ku atë që nuk e thotë Kushtetuta nuk mund ta thotë ligjvënësi. Kushtetuta e ka pasur mundësinë ta thotë, por nuk e ka thënë. Në këtë kuptim unë mendoj se ne jemi brenda urdhërimit kushtetues dhe brenda objektivit të saj madhor, strategjik për të realizuar depolitizimin e procesit të përzgjedhjes.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Po, zonja Bernhard.

Agnes Bernhard – *(flet përkthyesi)* Unë nuk shoh ndonjë kontradiktë me Kushtetutën. Neni 147 i Kushtetutës, paragrafi 8, thotë se procedurat e detajuara duhet të rregullohen me ligj. Kjo dispozitë kushtetuese nuk jep detaje se si duhet të kryhet kjo procedurë, pra emërimet. Dhe meqë ky nen thotë se procedurat e përzgjedhjes duhet të ndiqen me ligj atëherë dhe ne kemi bërë këtë procedurë, e kemi mbështetur në ligj dhe pastaj pas mbështetjes në ligj vazhdojnë procedurat me organet e tjera.

Ky paragraf mbështetet, gjithashtu, edhe në opinionin e Komisionit të Venecias i cili lidhet me emërimin, përzgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve jo gjyqtarë të këshillit,

pasi thotë që zgjedhja e anëtarëve jo gjyqtarë në këtë komision është e rëndësishme, duke u munduar që ta shkëpusim atë nga influenca politike, duke ndjekur një proces të hapur emërimi me iniciativën e hapur dhe të pavarur të institucioneve emëruese. Kjo procedurë do të sigurojë që parlamenti të bënte një emërim të këtyre anëtarëve në mënyrë më të përzgjedhur dhe larg influencës politike. E konsideroj si kushtetuese ndjekjen e kësaj procedure duke e mbështetur atë në ligj, gjë që do të krijonte bazën e një procedure emërimi që në fund të fundit mbështetet në parimet europiane. Që do të thotë një procedurë e hapur ku vetë ligji përcakton disa kriteret ku personat që i plotësojnë këto kriteret mund të kandidojnë në një procedurë transparente, e cila përcakton konceptet e qarta dhe mbi të gjitha do të sigurojmë një emërim bazuar mbi meritën. Në fund do të zgjidhen ata njerëz që e meritojnë, që kanë meritat më të larta.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Në fakt dëgjova komente nga ekspertët të cilët ndoshta do të përbëjnë sot precedentë për mënyrën se si ekspertët kanë ndërhyrë në këtë proces kushtetues.

Së pari, dua të them që jo në mënyrë të rastësishme Kuvendi i Shqipërisë e hoqi, e ndryshoi dispozitën që parashikonit ju si ekspertë, përfshirë dhe objektivat e reformës që mund të kenë qenë të miratuar në mënyrë të njëanshme. Pra, e ndryshoi. Ky është procesi kushtetues i ndryshimit të Kushtetutës. Bie dakord parlamenti dhe e vendos në një formë të caktuar. Dhe nëse ajo ka sjellë me vete ndryshimin e objektivave, është mbyllur historia dhe kokëfortësia qoftë e ekspertëve për të ndryshuar atë që është miratuar nga parlamenti është përveçse unike, edhe lapidare. Nuk është fjala se ju u gjendët në një terren bosh dhe menduat më të mirën. Kjo është dispozitë e hequr qëllimisht.

Po kështu Komisioni i Venecias, që citohet këtu, është shprehur mbi një dispozitë që ka parë më parë ku vërtet ishte me propozim nga institucionet, por nuk është shprehur fare me këtë dispozitë të re e cila ka një koncept krejt tjetër. Anëtarët jo gjyqtarë dhe jo prokurorë përfaqësojnë interesin publik dhe nuk përfaqësojnë organet, apo fushat përkatëse, nuk përfaqësojnë interesin e tyre në këtë proces, por përfaqësojnë interesin publik me vëstiturë nga parlamenti. Dhe për një arsye specifike që ne kërkojmë persona të cilët kanë karakteristika të caktuara të një formimi profesional, që i përshtaten sistemit,

kemi parashikuar që kandidaturat, ndryshe siç ishin më parë, që vinin për shembull nga Dhoma e Avokatisë, apo nga sajesa të tjera, vijnë nga fusha e avokatisë, nga fusha e profesorëve të drejtës, nga shoqëria civile, sepse mendohen se janë fusha nga ku mund të marrim profesionistët që na duhen për këtë sistem, por për interes të publikut me kandidim të hapur.

Dhe ndryshe nga çfarë ishte parashikuar më parë nga ju, ndoshta dhe për shkak të objektivave të reformës, Kushtetuta, në fazën e negociimit të diskutimit, është mirë t'u referoheni atyre që kanë qenë garantët e negociatës që janë dhe eprorët tuaj ditën e fundit të ndryshimeve kushtetuese. Ka qenë hapja e procesit për një kandidim të lirë për këdo, edhe për atë që mendon se i përputh, por nuk i kap kriteret. Pra, të gjithë. Është e drejta e çdo shtetasi shqiptar për të konkurruar sa kohë që mendon se i kap kriteret për të konkurruar për një detyrë në qeverisjen publike të vendit të vet. Kjo sanksionohet në deklaratën universale të Kombeve të Bashkuara dhe në dokumentin e Kopenhagenit të OSBE-së. Është një e drejtë që parashikohet në të dyja dhe nuk bëjmë përjashtim ne me Kushtetutën tonë. Ky është objektivi që vendosi Kushtetuta dhe jo ai që ndoshta dikur keni diskutuar dhe e përsërisni sot në mënyrë të paarsyeshme, në kundërshtim me atë që thotë Kushtetuta. Nëse do të kishim pasur atë qëllim, nuk do ta kishim prekur, do ta kishim lënë ashtu, do të ishin bërë vetëm ndryshime të tjera.

Por ajo që ju mendoni se është në tagrin qoftë dhe të ekspertëve për të menduar çfarë është më e mira, ndryshe nga çfarë ka miratuar Kuvendi, ndryshe nga çfarë ka përbërë bazën e konsensusit që është kthyer në germë, është unike. Kjo nuk ka ndodhur. Sigurisht edhe ekspertiza më e mirë që mund t'i vijë këtij komisioni nuk i qëndron dot përballë asaj që po ndodh kësaj radhe. Jo vetëm shkeljes së frymës, por edhe të germës. Dhe me idenë se me ligj mund të shtohen shumë gjëra që nuk i parashikon Kushtetuta unë besoj se duhet të bëjmë kujdes se ndoshta shkojmë shumë larg. Sigurisht një qëllim politik për të miratuar ligjin në mënyrë të caktuar, që mund të jemi dhe ne bashkë, nuk autorizon askënd qoftë dhe ekspertët që të miratojnë një ligj ndryshe nga çfarë është shkruar në Kushtetutë. Unë nuk dëgjova argumente, për fat të keq, të na thonë se pse. Unë e kuptoj e keni shkruar ju, e mbështesni ju edhe pse formalisht. Këto janë dispozita të paraqitura nga një grup deputetësh, por ata nuk janë sot këtu. Vetëm ky fakt që është

shkruar ndryshe në Kushtetutë duhet t'ju bëj të mendoheni, të nderuar ekspertë, që nuk mund të kapërcehet në mënyrë kaq flagrante.

Edhe një herë do të ishte mirë të konsultoheni me persona të cilët kanë qenë garantët e ndryshimit kushtetues në momentin e fundit, sepse përtej asaj sigurisht jeni përpara një gjëje që do ta bëjë vunerabël këtë për shkak se shkelet germa, shkelet fryma, shkelet konsensusi i 21 korrikut.

Arben Ristani – Për mua gjëja është e thjeshtë në këtë koncept. Për ta interpretuar Kushtetutën sigurisht që do t'i referohemi edhe debatit për miratimin e Kushtetutës. Në variantin e paraqitur nga ekspertët përpara se të miratohej Kushtetuta parashikohej pikërisht kështu me institucione propozuese dhe pastaj përzgjedhje nga parlamenti. Pas debatit që u bë mbi variantin që ishte përpunuar nga ekspertët, pas debatit që u bë dhe me mendimin e Komisionit të Venecias, u hoq propozimi nga organet propozuese dhe u la që dy anëtarë, jo gjyqtarë, zgjidhen nga radhët e avokatëve. Pra, nga radhët e avokatëve ishte e hapur, me propozim në Kushtetutë po nga këta ekspertë. Debatit kushtetues është i shkruar besoj për të ardhur në variantin përfundimtar. Pra, pas debatit që u bë, u hoq propozimi pikërisht sepse u mendua që është më mirë ta lëmë të lirë rrugën se sa duke i futur filtrin e hallkës propozuese. Tani nëpërmjet ligjit na ktheni prapë mbrapsht, shkojmë prapë te propozimi.

Tani ka një gjë, që edhe ne të mos flasim në ajër. A biem dakord që varianti i parë i Kushtetutës ishte kështu, me propozim, apo ne po themi diçka që nuk qëndron? Kështu ishte. Marrim variantin e Kushtetutës dhe shikojeni nëse ishte me propozim apo jo.

Dakord, bëjmë debat nëse nuk ka qenë, por unë di që ishte mbi bazën e propozimeve nga radhët e avokatëve dhe më pas thuhet që për çdo vend vakant, organet propozuese... Pra, ka organe propozuese, kështu ishte në variantin e parë të Kushtetutës. Pas debatit që ne bëmë, e hoqëm dhe e lamë që u takon direkt avokatëve që të sjellin propozim të lirë, kurse ne të përpunojmë kriteret. Ai që nuk i plotëson kriteret nuk shkon në Kuvend për t'u përzgjedhur, kurse ai që i plotëson kriteret shkon në Kuvend për t'u përzgjedhur.

Pra, ne nuk mund ta bëjmë këtë gjë pa iu referuar debatit kushtetues që të shikojmë si ishte dhe si e bëmë me Kushtetutën, për të ditur se çfarë donim të thoshim me

atë. Sepse ka një gjë. Pse duhet që pedagogët neve të na i zgjedhin krerët e institucioneve universitare? Sipas variantit që ju paraqisni, është parlamenti ai që do të zgjedhë mbi bazën e propozimeve që do të bëjnë krerët e institucioneve universitare? Pse të mos e lëmë, që pedagogët që plotësojnë kriteret të përzgjidhen nga parlamenti? Pse duhet të na diktojnë krerët e institucioneve universitare se kë duhet të përzgjedhim? Pse duhet që krerët e Dhomës së Avokatisë të na diktojnë se kë duhet të zgjedhim?

A ka qenë e tillë praktika në Shqipëri, që pushteti ka arritur t'i kapë kur formulat kanë qenë të tilla, sepse kanë qenë edhe herë të tjera të tilla dhe ka rezultuar që të gjitha ishin të kapura nga pushteti, pikërisht sepse kaloi nëpërmjet filtrit të organit propozues?

Po kthehem te çështja e parë, te debati kushtetues dhe i qëndroj kësaj. Në rast se varianti i parë ka qenë kështu siç them unë dhe pastaj mbi bazën e diskutimeve tona është ndryshuar për të ardhur në variantin që është sot, do të thotë që ne kemi përcaktuar se çfarë qëllimi kemi pasur. Kemi pasur qëllimin që ta hapim? Nëse kemi pasur qëllim që ta hapim nëpërmjet dispozitës kushtetuese, sot nuk mund ta kufizojmë me ligj. Për mua kjo ka vetëm një gjë, prandaj marrim debatin kushtetues. Projekti ka qenë kështu dhe është ndryshuar në këtë që kemi, apo jo? Në rast se e kam gabim, unë tërhiqem.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Ristani! Fjalën e ka zonja Hysi dhe më pas zoti Bumçi.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti Kryetar!

Kolegë të opozitës, më vjen shumë keq, që, meqenëse ju nuk keni marrë pjesë në mbledhjet e komisionit, sot flisni pa pasur parasysh se si ka qenë projektligji i depozituar nga grupi i ekspertëve dhe si ka ardhur formulimi sot, pas miratimit të Kushtetutës. Për këtë nen, ju keni pasur një vërejtje thelbësore lidhur me Këshillin e Lartë të Emërimeve. E para kjo.

Së dyti, lidhur me faktin se anëtari që do përfaqësonte avokatinë, noterinë që ka qenë atëherë, pedagogët, përzgjidhej direkt dhe i kalonte Kuvendit.

Pra, neni 3, që ju diskutoni sot dhe që unë kam draftin si ka qenë, për të cilin ka reflektime bazuar në formulë, është i ndryshëm dhe tashmë përputhet me Kushtetutën. Pse?

Duhet të keni parasysh tre elemente shumë të rëndësishme. Kush fillon propozimin për nominim, kush përzgjedh dhe kush zgjedh. Këta tre terma nuk janë e njëjta gjë. Në variantin siç ka qenë neni 3, lidhja ishte që zgjedh Kuvendi me propozim të mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, me propozim të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, të Dhomës Kombëtare të Noterisë e të tjera, kurse sot nuk është i tillë. Ju lutem, lexoni paragrafët 3, 4, 5, që ju kërkoni t'i ndryshoni. Paragrafi i tretë thekson se anëtarët që përfaqësojnë avokatinë zgjidhen nga Kuvendi, bazuar në propozimin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Ju keni thënë në relacionin e dorëzuar, që ne kemi bërë një deformim flagrant dhe kemi marrë kompetencat që ekskluzivisht i ka vetëm Kuvendi. Kolegë, kjo nuk është e vërtetë. Nëse i referohemi nenit 147 të Kushtetutës, në paragrafin e tretë, fjalia e fundit thuhet; “kriteret e tjera dhe procedura e përzgjedhjes”, jo e zgjedhjes. Pra, përzgjedhja paraprake rregullohet me ligj. A e kemi shkelur në Kushtetutën që në një ligj detajojmë kriteret e tjera, përveç kriterëve që ka përcaktuar paragrafi i tretë i nenit 147? Jo. Çfarë po bëhet? Po bëjmë zgjedhje apo po flitet për përzgjedhje? Flitet për përzgjedhje. Nëse ju kujtohet diskutimi apo debati kushtetues që kemi bërë, ju kolegë të opozitës e keni thënë dhe ne ju kemi mbështetur, që në Kushtetutë ne nuk mund të fusim çdo detaj, sepse e kemi bërë Kushtetutën rregullore, por shumë nga kriteret dhe procedurën e detajuar do ta bëjmë në një ligj. Për këtë zoti Xhafaj, këtu ju ka premtuar dhe ju ka thënë që këtu do të jemi, që gjithçka që flitet për detaje të kriterëve, do t'i fusim në ligj. Çfarë do të thoni ju dhe çfarë meraku do keni për ta detajuar procedurën? Do ta vëmë në ligj, sepse nuk mund të vëmë çdo gjë në Kushtetutë.

Gjithashtu, kolegë, meqenëse zoti Ristani pyeti se si ka qenë neni 3, po i them se neni 3, zoti Ristani, ka qenë neni për të cilin ju keni debatuar në dy pika. Ju keni thënë që nuk duhet të ketë korporatë. Këshilli i Lartë i Emërimeve, keni thënë ju...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni që tju lexoj tekstin se si ka qenë.

Përbërja e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe mandati i anëtarëve.

Pika 3 që dikur ka qenë pika 2, thotë: “Anëtarët gjyqtarë zgjidhen nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve në të gjitha shkallët. Anëtari që përfaqëson avokatinë zgjidhet nga Kuvendi, bazuar në propozimin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe me

rekomandim të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Anëtari që përfaqëson noterinë, zgjidhet nga Kuvendi bazuar në propozimin...”

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më fal, të mbaroj pak.

Nuk propozon....

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më fal! Lidhja këtu është e...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pandeli Majko - Lëre të mbarojë.

Të mbaroj njëherë unë.

Zoti Ristani, merr mundimin dhe minimumi që duhet të bësh është të lexosh nenin 3 siç ka qenë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë po të lexoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë...

Fatmir Xhafaj - Zonja Hysi, ju lutem mbylleni mikrofonin!

Zoti Ristani, a ka mundësi të lutem!

Vasilika Hysi – Ta mbaroj fjalën unë.

Fatmir Xhafaj - Do ta ndjekësh debatin apo do të bësh zhurmuesin?

Vasilika Hysi - Pra, në variantin siç ka qenë neni 3, propozimi nga këto institucione i shkonte direkt seancës plenare, kurse tani kandidatët e përzgjedhur nuk i shkojnë seancës plenare, sepse ne kemi futur komisionet *at hoc*.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju keni ardhur për të bërë zhurmuesin, kurse unë kam ardhur këtu për....

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, ju lutem dëgjojeni!

Në rast se hapim procesverbalet për debatet që janë bërë, ju keni bërë debat për Këshillin e Lartë të Emërimeve, prandaj ju lutem lexojini procesverbalet se i keni në internet. Për Këshillin e Lartë të Emërimeve, ju keni sjellë si argument se duke qenë se

përbëhet nga drejtues të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarë, kjo krijon një korporativizëm, si dhe keni thënë që duam të rritet roli i parlamentit.

Çfarë solli formula? Solli një rritje të rolit të parlamentit, duke futur pozicionin e sekretarit të përgjithshëm, ka futur komisionin, një nënkomision, ka sjellë një grup që përbëhet nga deputetë të shumicës dhe të pakicës parlamentare, thotë Kushtetuta. Këto janë risitë e kompromisit të datës 21 qershor. Gjithashtu, ju keni hequr Këshillin e Emërimeve në Drejtësi dhe kjo është pranuar kur ka qenë pjesë e negociatave politike, por ju nuk keni goditur...

(Debate pa mikrofon.)

Pra, si ju, edhe ne nuk kemi qenë kundër që të ketë pluralizëm.

E fundit fare zoti kryetar.

Nuk është e vërtetë që zgjedhjen e bëjnë këto trupa, sepse zgjedhjen e tyre, e bëjnë në radhë filtash: është sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, i cili vlerëson kriteret formale, është nënkomisioni, ka rregulla dhe e fundit fare është seanca plenare. Prandaj zoti kryetar, do të doja....

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do mbani qetësi dhe të dëgjoni? Lexoni si ka qenë neni 3 i ligjit dhe si është bërë. Riformulimi i nenit 3 të ligjit që ne po diskutojmë, respekton kriteret kushtetuese të përcaktuara në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 147 të Kushtetutës.

Fatmir Xhafaj - Po. Zoti Kruja, zoti Manja, zoti Bumçi dhe zoti Muçmata.

Keltis Kruja - Duke qenë se ndahemi tek antikushtetutshmëria, te fakti se kush i zgjedh dhe kush i përzgjedh, në konceptin tuaj kjo nuk është procedurë zgjedhjeje, por procedurë përzgjedhjeje, apo jo? Dhe si e tillë nuk është antikushtetuese.

Vetëm nga ana formale, unë dua t'ju citoj vetëm titujt e neneve, të cilat flasin "për përzgjedhjen e kandidatëve".

Mbledhja e përgjithshme.

Kuorumi.

Procesi i votimit.

Numërimi i votave dhe shpallja e rezultatit.

Ankimimi.

Në qoftë se ju këtë e quani proces përzgjedhjeje, mua nuk më duket.

Kemi nene të detajuara nga fillimi deri në fund me procedurën me të cilën zgjidhen tashmë kandidatët, avokatë dhe pedagogë. Nuk përzgjidhen, por zgjidhen, dhe këtë e thotë edhe ligji që kemi përpara, që edhe nga ana formale këto janë zgjedhje, jo përzgjedhje.

Tani vijmë te fakti tjetër që ju, ekspertët, thoni, që meqë Kushtetuta nuk ka qenë eksplicite, neve na lind e drejta të ndërhyjmë dhe ta rregullojmë me ligj, por jo ta deformatojmë atë. Në fakt, Kushtetuta është shumë eksplicite te kjo procedurë, sepse parashikon edhe kush i përzgjedh kandidaturat, që është sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit i futur në Kushtetutë, pikërisht se është pozicion administrativ, jo politik. Pra, sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit përzgjedh dhe pastaj detajon krijimin e një nënkomisioni *at hoc* nga Komisioni për Çështjet Ligjore, i cili ka tagrin e vlerësimit dhe të kualifikimit të kandidaturave. Madje i keni dhënë edhe një instrument, që me shumicë të cilësuar votash mund të përfshijë në listë edhe kandidatura që nuk i ka kualifikuar sekretari i Përgjithshëm. E detajon Kushtetuta procesin e përzgjedhjes, apo jo?

Në qoftë se ne do të themi që meqë Kushtetuta, për ju, nuk e paska përcaktuar në germë këtë, neve na lind e drejta të ndërhyjmë dhe ta deformatojmë totalisht, sepse unë nuk di se si mundet që atë që ia ka dhënë Kushtetuta sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit dhe komisionit *at hoc*, ne t'ia marrim nëpërmjet disa procedurave zgjedhore dhe jo përzgjedhëse. E keni rregulluar dhe keni dhjetë nene në të cilat flisni vetëm për zgjedhje, jo për përzgjedhje. Në qoftë se kjo juve ju duket kushtetuese në germë, mua më duket edhe në frymë, edhe në germë antikushtetuese, sepse kështu e keni shkruar dhe ne këtë po themi. Atëherë, çfarë do vlerësojë sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit? Pse duhet që ne ta kufizojmë me ligj që mbledhja e përgjithshme e avokatëve do zgjedhë një numër të caktuar kandidatësh? Pse duhet që ne ta kufizojmë me ligj që mbledhja e trupave pedagogjike do zgjedhë një numër të caktuar kandidatësh, ndërkohë që Kushtetuta e thotë që zgjidhen nga radhët e avokatëve dhe nga trupa e pedagogëve dy anëtarë? Më poshtë detajon kriteret e kualifikimit, dhe sipas Kushtetutës, përzgjedhja bëhet nga sekretari i Përgjithshëm dhe më tej nga Komisioni *at hoc*. Tani, t'ia marrësh parlamentit atë që ia ka dhënë Kushtetuta në diskrecionin e tij dhe ta quash këtë që është plotësim i Kushtetutës, unë vetëm te kjo sallë e dëgjoj dhe nuk besoj se do ta dëgjoj më në salla të tjera, por, absolutisht, në qoftë se ka rast që Kushtetuta është eksplicite në mënyrën se si

përzgjidhen dhe se si do të votohet lista e kandidatëve të përzgjedhur, unë besoj se është ky rasti.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, kryetar!

Në fakt, këtu po flasim për një proces kushtetues dhe ligjor të ngritjes dhe kompozimit të organeve qeverisëse të drejtësisë. Kur flitet për një proces kushtetues dhe ligjor, është mirë që pikë së pari, të mos kemi paragjykitime mbi mënyrën se si duhet lexuar ky proces nga pikëpamja kushtetuese.

Unë do t'u referohem dy dokumenteve, tashmë të pranuar nga të dyja palët politike. Do t'i referohem opinionit final të Komisionit të Venecias që tashmë është pranuar publikisht nga kolegët e opozitës, si edhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila në mesnatën e datës 21 dhe 22 korrikut është votuar me 140 vota. Çdo lexim i Kushtetutës tej këtij kuadrati, opinionit final të Komisionit të Venecias dhe tekstit kushtetues, kam bindjen se na çon në deformime. Çfarë thotë Komisioni i Venecias në pikën 16 të opinionit final? Përdor dy terma.

Në lidhje me anëtarët jo gjyqtarë thotë: procesi i nominimit, pra i kandidimit apo i përzgjedhjes, është po aq i rëndësishëm sa metoda e zgjedhjes së tyre. Distanca e tyre nga politika, mund të sigurohet vetëm nëpërmjet një procesi të hapur dhe transparent nominimi, me nismën e organeve të pavarura nominuese, universitete, dhoma avokatie, OJQ, e të tjera. Ky proces nominimi, thotë, duhet të bëjë të mundur që parlamenti të detyrohet të bëjë një përzgjedhje mes kandidatëve më të kualifikuar dhe jo të emëruarve politikë. Ky është dokumenti që të dyja palët e kemi pranuar. Arbitri, kemi thënë ne, do të jetë Venecia.

Çfarë kemi bërë ne natën që kemi votuar Kushtetutën? As më shumë dhe as më pak, por këtë rekomandim të Komisionit të Venecias, e kemi materializuar në nenin 147-të, pika 3 e Kushtetutës, ku thuhet që anëtarët jo gjyqtarë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë punë në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti, gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera dhe procedura për përzgjedhjen e kandidatëve rregullohen me ligj dhe në pikën 4 të po këtij neni, flitet për zgjedhjen e kandidatëve. Pra, edhe

Kushtetuta përdor dy nocione juridike, nocionin përzgjedhje dhe zgjedhje. Natyrisht që përzgjedhja është një proces seleksionimi nga radhët e profesionistëve siç rekomandon Venecia, sepse përzgjedhja me zgjedhjen duhet të sigurojnë një distancë të caktuar nga politika. Tani, unë nuk e kuptoj se ku ky zbërthim bie ndesh me Kushtetutën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe një sekondë se mbarova.

Unë nuk e kuptoj se ku bien ndesh me Kushtetutën përcaktimet e bëra në nenin 3 dhe në vazhdim, lidhur me procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve që do të vijnë nga radhët e avokatisë, sepse Kushtetuta është shumë e qartë në këtë pikë?

Së dyti, dhe tani po flas si jurist apo si teknikien, përse qenka më pak demokratike një garë mes profesionistëve dhe të të njohurve dhe qenka më demokratike një garë duke dorëzuar kërkesat në Kuvendin e Shqipërisë?

Jo. E rëndësishme është që Kushtetuta dhe ligji të garantojnë të drejtën e gjithsecilit, po flas nga radhët e avokatisë, një armatë prej 13 apo 14 mijë avokatësh, si dhe rregulla të njëjta dhe të barabarta kushtetuese për të marrë pjesë në një garë. Pastaj, nëse gara do zhvillohet mes avokatëve apo mes avokatëve në Sekretarinë e Përgjithshme të Kuvendit të Shqipërisë duke dorëzuar dokumentet dhe dosjen e kandidimit, mua nuk më duket se procesi këtu është më pak demokratik dhe këtu qenka më shumë demokratik. E rëndësishme është, që ne t'i garantojmë gjithsecilit të drejtën kushtetuese dhe ligjore që të marrë pjesë dhe të jetë pjesë e garës.

Unë kështu e lexoj Kushtetutën, kështu e kam lexuar edhe opinionin e Komisionit të Venecias, sepse për hir të së vërtetës, për ta lexuar si duhet opinionin e Komisionit të Venecias, më kanë qartësuar gjatë vazhdimit të debatit para se të miratojmë Kushtetutën, kolegët e mi të opozitës. Me këmbënguljen e rekomandimit të famshëm 88, si dhe draftin e opinionit final të Venecias, më kanë detyruar, që, pse jo, dhe më vjen mirë, që ta mbaj edhe unë veten se e kam lexuar shumë mirë opinionin final të Komisionit të Venecias, sepse kështu më ka mësuar Oerdi. Lexoje Venecian, më thoshte, lexoje nenin16, lexoji rekomandimet 17 dhe 18. Në fakt unë i kam lexuar dhe Venecia me Kushtetutën më përputhen pikë për pikë, kurse tani këta thonë jo, jemi bërë pishman.

Unë mendoj, që, edhe për procedurë, të ecim nen për nen dhe nuk është e thënë të biem dakord për gjithçka. Aty ku biem dakord, biem dakord, kurse aty ku nuk biem dakord, jemi brenda logjikës kushtetuese dhe brenda logjikës së ligjit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, sepse është me radhë! Këtu nuk veprohet duke vendosur shishen e qumështit. Tani radhën e ka zoti Bumçi, më pas zoti Majko dhe pastaj ju përsëri. Të lutem!

Zoti Bumçi, ju siguroj që nuk do ju ndërpresë asnjëri.

Aldo Bumçi - Faleminderit, zoti kryetar!

Të gjithë shqetësimin unë e kam për ekspertët e huaj. Qëndrimi juaj, për t'i dhënë legjitimitet një qëndrimi apo një tjetri, është shumë i rëndësishëm. Debatimi është teknik, por besoj se ju e kuptoni që bëhet fjalë për çështje shumë delikate. Patjetër që ju jeni nisur me vullnet të mirë, por ju lutem, dëgjoni edhe shqetësimet tona. Do të përmend tre prej tyre.

Së pari, Kushtetuta nuk krijon institucione të tjera përveç Kuvendit, kurse me ligj, ju po krijoni një proces të ri, që nuk është në Kushtetutë. Mund të aplikojnë 100 pedagogë, por ju thoni, që vetëm 20 prej tyre do vijnë në Kuvend, kurse 80 të tjerët do përjashtohen nga ky institucion i panjohur. Këtë Kushtetuta nuk e thotë, dhe nuk ia ka dhënë askujt të drejtën të jetë filtër. Të gjithë janë të lirë të vijnë në Kuvend dhe pastaj do jetë Kuvendi ai që do të vendosë.

Së dyti, për të vlerësuar një pedagog, për sa u përket kritereve dhe cilësisë, shikohet CV-ja e tij, çfarë ka mbaruar, shkollën e lartë apo dhe doktoraturë, ku e ka mbaruar, sa botime ka, sa vjet ka që jep mësim, sa tema doktorature apo pasuniversitare ka drejtuar. Pra, janë kritere konkrete, dhe nuk ka nevojë që ta përcaktojë konferenca, se cili pedagog është më i mirë. Puna ndër vite e një pedagogu, është thjeshtësisht e matshme, janë botimet shkencore, konferencat, e kështu me radhë. Pra, nuk sillni asnjë përmirësim nga ana cilësore, sepse CV-ja përmban gjithçka.

Së treti, por dhe më e rëndësishmja, është se i gjithë merakun ynë ka të bëjë me kapjen politike të procesit, dhe besoj se ju këtë e kuptoni, sepse në momentin që ka filtra

të tillë, kapja politikisht bëhet më e lehtë. Ne kërkojmë një proces të lirë, ku të 100 pedagogët që aplikojnë, të vijnë të gjithë në Kuvend dhe jo 80 apo 90 prej tyre të përjashtohen.

Shembujt janë të shumtë. Besoj se ju jeni në dijeni, që në procesin e zgjedhjes së rektorit dhe dekanit të fakultetit të Tiranës, u përfshi krimi i organizuar dhe këta persona sot janë arrestuar dhe janë në burg. Pra, nuk po flas për hamendësime, por për fakte. Është në media që ndërhyjnë policia, prokuroria dhe u bë një zhurmë shumë e madhe, që në procesin e zgjedhjes së rektorit dhe dekanit, u përfshi krimi i organizuar dhe personat që bënë kërcënimet, janë pjesë e një bande të njohur në Tiranë. Sot ata janë në burg. Ky është një shembull i ndërhyrjes së krimit të organizuar në këto filtra që ju po vendosni.

Së dyti, me ligjin e ri të arsimit të lartë, do krijohen borde, të cilat do kontrollojnë edhe universitetet private, si dhe do japin edhe fonde. Pra, nuk duhet të ketë filtra dhe Kushtetuta nuk i parashikon, sepse nuk sjellin asnjë vlerë të shtuar për vlerësimin e kandidatëve nga ana cilësore, por është CV-ja e tyre ajo që flet.

Së treti, ndihmon në kapjen...

Ka pasur një debat shumë të gjatë për këtë Kushtetutë, kurse ju po ktheheni pas, jo në variantin e miratuar, por në një variant që na u vendos në tavolinë. Kopje, besoj e mbani mend. Një akt i turpshëm, që na u vendos në tavolinë një Kushtetutë e pa miratuar, dhe ju po shkoni tek ai variant, jo te varianti i miratuar.

Këto janë arsytet, që qëndrimi juaj si ekspertë këtu është shumë i rëndësishëm. Në qoftë se ju jeni nisur me vullnet të mirë, por pa u thelluar, besoj se tashmë faktet janë të plota. Këta filtra, në një vend si Shqipëria rrezikojnë të kapen, dhe unë ju solla shembuj që nuk sjellin asnjë vlerë të shtuar. Qëndrimi juaj, për të qenë teknikë ose për të treguar që jeni të politizuar, është shumë i rëndësishëm.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Bumçi!

Fjalën e ka zoti Majko.

Pandeli Majko - Unë e mirëkuptoj deri në një farë mase vërejtjen e kolegëve të opozitës. Sipas tyre, në Kushtetutë është shkruar ndryshe, kurse ne po bëjmë një ligj, me të cilin kërkojmë të ndryshojmë procedurën. Në rregull? Në esencë, kur një diskutim shtrohet në këtë mënyrë, diskutimi bëhet për qëllime politike, që do të thotë, se ne të

maxhorancës, po kërkojmë të kontrollojmë me mënyrat tona pesëshen që do dalë nga parlamenti.

Tani, problemi që unë shtroj, dhe të më falin kolegët që kanë folur para meje, është: e gjithë procedura do bëhet nga sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, i cili do ia dërgojë një nënkomisioni të përbërë nga tre përfaqësues të maxhorancës dhe dy të opozitës. Më korrigjoni nëse e kam gabim. Në bazë të procedurës, për çdo kandidaturë të rrëzuar nga sekretari apo sekretarja e Përgjithshme, duhen 3+1 të votave.

Më falni kolegë! Ju mendoni se kështu sistemi bëhet më i pavarur? Vetëm kaq.
(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, do ta them unë në vazhdim!

Ju thoni, që një mijë avokatë në Shqipëri, të cilët duan të hyjnë apo të aplikojnë, duhet të vijnë te sekretarja e Përgjithshme. Ne po ju themi, se meqenëse, anëtarët që janë do vijnë nga radhët e gjyqësorit dhe do miratohen nga mbledhja e të gjithë gjyqtarëve, e njëjta gjë të bëhet si me avokatët, ashtu dhe me profesoratin.

Ju lutem, a ka mundësi?

Varianti juaj në sensin e pavarësisë së gjyqësorit, na jep këtë formulë. A po e diskutojmë në parim? Garanti, thoni ju, është sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, a ka mundësi të vazhdoj?

Sekretari i Përgjithshëm ka një filtër të tillë, të depolitizuar, i cili sfidon edhe shumicën e nënkomisionit. Ne jetojmë në Shqipëri dhe e dimë se si zgjidhet sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, i cili është ndërruar rregullisht sa herë është ndërruar qeveria në Republikën e Shqipërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, a ka mundësi?

Sekretari i Përgjithshëm, që sipas jush, do të jetë garanti për të gjitha aplikimet nga e gjithë Shqipëria, do jetë garanti përballë nënkomisionit, kur për të hedhur poshtë vendimin e sekretarit të Përgjithshëm, duhet të bashkohet maxhoranca me opozitën? Ju lutem!

Ajo që ne po ju kërkojmë, dhe që është brenda frymës së shinave të asaj që ka propozuar Kushtetuta, është që të vijmë nga Dhoma e Avokatëve, i njëjti mekanizëm që është përdorur edhe për gjyqësorin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka mundësi, sepse unë nuk ju ndërhyra?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ajo që ne po diskutojmë në parim, është që ju na thoni, se kjo që mbroni ju është mbrojtje e pavarësisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Parimi fillon nga kjo që ne po diskutojmë. Të dyja palët, jemi mbledhur këtu për të bërë një reformë, e cila duhet të garantojë pavarësinë e gjyqësorit. Ju thoni që sekretari i Përgjithshëm e garanton pavarësinë, kurse ne themi që mbledhja e Dhomës së Avokatëve, e të gjithë avokatëve, është më garantuese se sa kjo. Ju thoni, që aplikimi i një profesori te sekretari i Përgjithshëm, e garanton më shumë se sa mbledhja e gjithë profesoratit.

Ju lutem, ka mundësi të vazhdoj?

Meqenëse e doni pikë për pikë, siç është e shkruar në Kushtetutë, po e sjell me një shembull.

Në projektligjin e SPAK-ut, ju kërkon një komision *ad hoc* të zgjedhur me gogla, që nuk ekziston në asnjë nen të Kushtetutës apo të ndonjë ideje që është diskutuar këtu, që të rishikojë të gjitha dokumentet që do prodhojë DSIK-ja, pra siguria, dhe ILDKP-ja.

Pra, në pikëpamjen që po diskutojmë, të dashur kolegë, ne kemi dhe shumë prova të tjera, që nenet e Kushtetutës nuk duhen parë thjesht të ngurta.

Së fundi, të gjithë këtë diskutim ne po e bëjmë se si të garantojmë pavarësinë.

E gjithë historia juaj, e ashtuquajtura shkelje kushtetuese, është që Dhoma e Avokatëve, është më pak e pavarur sesa sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

Ju lutem!

E gjithë historia që ju ofroni është, që mbledhja e profesoratit, e cila do të votojë kandidaturat që do të vijmë në Kuvend, është më pak e pavarur sesa sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

Ju lutem!

Nga çdo anë që ta marrësh....

Kolegu im, Manja, lexoi atë çfarë kishte shkruar Komisioni i Venecias, në pikën 16 të konkluzioneve të fundit të tij. Ju lutem, ta shikojmë pak më me gjakftohtësi! Brenda frymës së neneve të Kushtetutës, ne po kërkojmë t'i garantojmë më shumë pavarësi sistemit. Kaq.

Fatmir Xhafaj - Zoti Majko, ju lutem a ka mundësi, sepse po e ktheni në pazar?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Lërë atë tani, me mikrofon, pa mikrofon. Bëjmë debatin dhe mbarojmë si njerëz të...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem!

Çfarë rëndësie ka, se ju po e ktheni në debat personal.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Keni ndonjë koment tjetër?

Po. Zoti Ristani ka koment tjetër.

Arben Ristani - I gjithë problemi është që ne t'i qëndrojmë Kushtetutës që kemi miratuar. Gjatë debatit që bëmë me njëri-tjetrin, doli që teksti jo përfundimtar i Kushtetutës, por ai mbi të cilin kemi debatuar, parashikonte organe propozuese. Këtu në bisedë, u konfirmua, që teksti i Kushtetutës ka qenë i tillë, që parashikonte organe propozuese, dhe pas debatit që ne kemi bërë, i kemi hequr këto organe, pikërisht me qëllimin që oferta të ishte e lirë. Ne do të caktonim me ligj kriteret, kurse seleksionimi do bëhej mbi bazën e tyre, të cilat sipas Kushtetutës, do paraqiten te sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe pastaj do jetë ai që do bëjë përzgjedhjen. Pra, u pranua. Edhe zonja Hysi, kur lexoi tekstin e punës së Kushtetutës, e konfirmoi që ka qenë me organe propozuese.

Po, teksti ka qenë i tillë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po pra, ka qenë me organe propozuese dhe e hoqëm propozimin, pikërisht që ofertën ta kishim të lirë, dhe siç e thotë Kushtetuta, dy anëtarët jo gjyqtarë, zgjidhen nga radhët e avokatëve. Më pas, është sekretari i Përgjithshëm, ai që, pasi merr propozimet, shikon nëse i plotësojnë ose jo kriteret dhe të gjithë ata që i plotësojnë kriteret, vijnë. Pra

është e hapur, kurse me ligj, duke futur filtrin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë, ju e kufizoni. Pra, është Dhoma Kombëtare e Avokatisë, ajo që bën përzgjedhjen e parë për të çuar listën e kufizuar te sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, ndërkohë që, Kushtetuta e ka të lirë gjënë. Ju thoni, që Dhoma Kombëtare e Avokatisë, që sigurisht dominohet nga ata që e drejtojnë, për këtë ju të jeni të bindur, dhe sipas ligjit, janë ata që do përzgjedhin të parët se cilët do vijnë te sekretari i Përgjithshëm, dhe pastaj është sekretari i Përgjithshëm ai që do bëjë seleksionimin sipas Kushtetutës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, nuk kam mbaruar.

Atëherë, a është kështu, që është mbledhja e Dhomës Kombëtare të Avokatisë ajo që do të sjellë propozimet, sipas ligjit tuaj? Kështu është. Pse habitesh? Pra, sipas Kushtetutës, do jetë ajo e para që do të bëjë seleksionimin, pastaj seleksionimin e dytë do ta bëjë sekretari i Përgjithshëm.

Kjo po propozohet, apo jo? Ne po ju themi, që kjo fut një filtër, që më pas kondicionon përzgjedhjen e sekretarit të Përgjithshëm, ashtu sikurse do të ndodhë edhe me pedagogët. Ne po themi, që çdo pedagog i Të drejtës, që mendon se i plotëson kriteret, të ketë të drejtën të garojë. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, sipas Kushtetutës, shikon plotësimin ose jo të kriterëve dhe përgatit listën përfundimtare, e cila i vjen Kuvendit për votim, kurse ju thoni, që të vijnë kandidaturat e pedagogëve dhe përzgjedhjen e parë ta bëjnë drejtuesit e institucioneve universitare. Pra, sipas ligjit që, “Anëtarët që përfaqësojnë trupën e pedagogëve të drejtësisë, zgjidhen nga Kuvendi, bazuar në propozimin e mbledhjes së posaçme të drejtuesve të institucioneve pedagogjike”.

Pra, a duan pedagogët të jenë pjesë e organeve që duam të zgjedhim ne? Po. Sipas Kushtetutës, ata ofrojnë veten e tyre, përgatitet lista, e cila më pas vjen te sekretari i Përgjithshëm dhe është ai që shikon nëse i plotësojnë apo jo kriteret. Kurse ju thoni që, me ligj, janë drejtuesit e institucioneve pedagogjike ata që seleksionojnë të parët dhe vendosin që ky do shkojë, kurse ky tjetri jo.

Pra, drejtuesit e institucioneve pedagogjike, të zgjedhur nën ndikimin e bandave, siç rasti konkret, që u arrestuan dhe u futën në burg, nën pushkën e bandave, do të përzgjedhin kandidaturat që do të drejtojnë organet kushtetuese. Kjo është fare e qartë,

dhe me plotë gojë, unë them, që edhe ekspertët që mbrojnë gjëra të tilla, për mua janë të kapur nga maxhoranca, politika dhe mos të them edhe nga bandat e krimit.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Majko.

Pandeli Majko - Unë mendoj që këtu nuk po diskutojmë deklamime politike, sepse për deklarata politike jam dakord. Gjithashtu, zotëri, për ato çka the për ekspertët, mendoj se duhet të skuqesh pak. Gjithsecili vjen këtu për të mbrojtur logjikën e të parit të çështjes në mënyrë profesionale dhe nuk vjen për asnjë lloj bande dhe histori të tjera që thatë ju. Kini respekt për këtë tavolinë.

Meqenëse thatë që është shkelur Kushtetuta, po e përsëris edhe një herë pikën 4, të nenit 147: “Dy anëtarë jo gjyqtarë, zgjidhen nga radhët e avokatëve dhe dy anëtarë nga trupa e pedagogëve”. Tani më falni, lexojeni mirë, sepse thotë nga radhët e avokatëve, nuk thotë që duhet të jetë avokat! Lexojeni mirë, sepse thotë dy anëtarë nga trupa e pedagogëve, nuk thotë që duhet të jetë pedagog. Në thelb, ky lloj interpretimi....

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zotëri, ju mund të qeshni, por sapo na bëtë lidhje të shkurtër, se shmangia e sekretarit të Përgjithshëm, është akt kriminal dhe i shërben bandave të mafies shqiptare. Merreni pak më me qetësi dhe gjakftohtësi këtë lloj historie që po diskutojnë ne. Në qoftë se shikoni intension për ta kontrolluar politikisht, ju nuk keni besim tek asnjë lloj trupe, përveç trupës që kontrolloni ju, me votë të partisë suaj. Këtë thoni. Hapur.

Ju nuk besoni as trupën e avokatëve dhe as trupën e profesoratit që të votojë, por doni që ta zgjidhni ju me dorën tuaj dhe t’i thoni që të kemi zgjedhur ne. Kjo nuk mund të funksionojë kështu.

Vexhi Muçmataj - Faleminderit, zoti kryetar!

U bënë shumë diskutime, natyrisht u dhanë shumë argumente, dhe ndoshta kanë shteruar edhe argumentet që mund të jepen, por unë dua të them shkurt dy fjalë.

Zoti Manja, po ashtu edhe zonja Vasilika, përmendën rekomandimet e Komisionit të Venecias, në frymën e të cilave, Kushtetuta dhe ligji në fjalë, kanë formuluar dispozitat përkatëse.

Unë do të citoj nenin 3, ku kërkohet që “kriteret e veçanta, kriteret e tjera dhe procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve, të rregullohen me ligj”. Pra, është fjala për kandidatët jo gjyqtarë. Mendoj se hartimi i një ligji të posaçëm, siç është ligji organik,

është i detyrueshëm. Pra, besoj se biem dakord, që është detyrim kushtetues, që ne të hartojmë një ligj për të përcaktuar procedurat e mëtejshme për zgjedhjen e anëtarëve jo gjyqtarë. Në zbatim të këtij detyrimi kushtetues, është hartuar edhe ligji “Për qeverisjen e gjyqësorit”. Ky është detyrim dhe ne nuk mund t’i shmangemi dot.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më fal, ta përfundoj arsyetimin!

Pra, unë mendoj se ne duhet ta përmbushim këtë detyrim kushtetues, siç është përmbushur në ligjin në fjalë, duke përcaktuar procedurat konkrete për përzgjedhjen e anëtarëve jo gjyqtarë, dhe kjo është ajo që ka bërë ligji “Për organizimin e qeverisjes së gjyqësorit”.

Në paragrafin 7 të nenit 6, thuhet se sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, pas përfundimit të verifikimeve, i dërgon menjëherë nënkomisionit listën me kandidatët që plotësojnë kriteret e formimit.

Shikoni nenin 35 të ligji që po diskutojmë. Pra, pasi kanë mbaruar procedurat, Sekretari i Përgjithshëm, thotë të njëjtën gjë që kërkon edhe ligji.

Pra, ky detyrim kushtetues, ka pasur parasysh pikërisht rregullimin me ligj të veçantë, të procedurave për përzgjedhje dhe pastaj, kjo e ngarkon sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit të vazhdojë më tej.

Kështu që, përderisa ne e kemi detyrim kushtetues hartimin e ligjit për të përcaktuar procedurat, mendoj se ne duhet ta respektojmë këtë detyrim. Pastaj, nëse procedurat duhet të jenë më të shkurtra apo më të gjata, ajo është çështje e vullnetit të ligjvënësve për t’i përcaktuar ato. Mendoj, se procedurat e përcaktuara, janë të plota, transparente dhe i shërbejnë përzgjedhjes së kandidatëve, me qëllim që të jenë sa më larg ndikimit politik. Kjo është shumë e rëndësishme dhe është pikërisht strategjia e reformës që ne kërkojmë të bëjmë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Muçmataj!

Zoti Kruja, ta mbyllim, sepse kemi diskutuar nga një herë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po. Fjalën e ka zoti Kruja.

Keltis Kruja – Sigurisht që e kam edhe unë merakun që ka zotit Majko, i cili është merak legjitim, që ka të bëjë me kapjen ose moskapjen e sistemit. Ne nuk mund ta kapim sistemin, sepse jemi në opozitë.

Marrëveshja e 21 korrikut dhe Kushtetuta që miratuam së bashku, garantoj pakicën parlamentare, nëpërmjet mekanizmave të përcaktuara në Kushtetutë, dhe ne pikërisht këtë po kërkojmë, zbatimin germë për germë të Kushtetutës që kemi miratuar së bashku, kurse ju thoni, që paskemi bërë një gabim në Kushtetutë, sepse mundet që sistemi të kapet nga Komisioni *ad hoc*, prandaj duhet që ne ta rregullojmë me ligj këtë gjë. Sikur nuk më del mirë llogaria te kjo pjesë. Kushtetuta i ka të përcaktuara qartë organet dhe rolin e tyre, të cilat përzgjedhin dhe pastaj kualifikojnë listën për në Kuvend. Edhe Komisioni *at hoc* apo nënkomisioni, ka pikërisht rol përzgjedhës.

Për çfarë arsye duhet që ne t'i fusim mbledhjet e përgjithshme të trupave tokësore dhe detare, që të përzgjedhin përpara organeve, të cilat i ka në mënyrë eksplicite Kushtetuta? Për çfarë arsye duhet të kufizohet numri i kandidaturave, me vendim sepse nuk është përzgjedhje, në rastin që këshilli drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë bën kualifikimin në bazë të dokumentacionit? Çfarë kualifikimi tjetër do të bëjë sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit? Çfarë kualifikimi tjetër do të bëjë Komisioni *ad hoc*, nënkomisioni që do ngrihet, sepse unë këtë nuk e kuptoj? Në qoftë se ne kemi kritere që do parakualifikojnë kandidatët, të cilat janë të vendosura me ligj, pse duhet mbledhja e përgjithshme e trupave pedagogjike apo avokatore? Më keq akoma, si mundet që një proces, të cilin e vendos mekanizmi i votës së përgjithshme, sepse kjo është votë e përgjithshme, ne ta quajmë proces përzgjedhës dhe këtu nuk paska asnjë problem? Po për çfarë votojnë ata pra, në qoftë se është përzgjedhës? Mua më duket *non sens*.

Ky projekt, do ishte dëshirë mirë apo i pafajshëm për ato që po themi ne, pra për kapjen e drejtpërdrejtë dhe kontrollin politikë të sistemit, apo edhe nga segmente të tjera të këtij sistemi, minimalisht nuk duhet të kishte parashikuar mekanizmin e votës. Mund të kishte një parakualifikim nga radhët e avokatëve, por mbi bazë të dokumentacionit që sjellin, dhe jo mbi bazën e votimit të përgjithshëm të kandidatëve, sepse ky është proces zgjedhor dhe vendimmarrës, që ndërhyr drejtpërdrejtë në vendimmarrjen e Kuvendit, e cila i është dhënë nga Kushtetuta që kemi miratuar së bashku. Sigurisht që Kushtetuta është politike, sepse e kemi miratuar të dyja palët. Gjithashtu, ne kemi pasur negociata

për të miratuar këtë tekst kushtetues që kemi sot, kështu që nuk mund të themi që, meqë kushtetuta e parashikon që do t'i përzgjedhë ky komision politik, atëherë ne e paskemi bërë gabim, ndaj duhet t'i rikthehemi.

Në qoftë se keni këtë ide, ju mund ta kishit thënë edhe më parë, sepse është i njëjti diskutim që bëme dje për standardet kushtetuese. Për dispozitat transitorë që ne kërkuam për Ligjin e Prokurorisë, për vërejtjet që bëme për Ligjin e Prokurorisë dhe për çështje të tjera që ne bëme, në qoftë se e mbani mend, ju thatë që nuk e lëvizim dot, sepse është Kushtetuta që miratuam në mes. Kurse sot thoni, se edhe mund të kemi bërë ndonjë gabim në Kushtetutë apo nuk e kemi bërë siç duhet, prandaj duhet ta korrigjojmë atë. Apo jo? Nuk mund të kemi dy standarde kushtetuese, por një.

E ritheksoj përsëri dhe shembullin po jua marrë nga dje. Dje thatë që nuk lëvizim asgjë, sepse nuk mund të ikim nga Kushtetuta, kurse sot po thoni, se Kushtetuta ka vende ku ne mund ta rregullojmë, sepse mund ta kemi bërë edhe gabim. Nuk ka ndonjë gjë.

Fatmir Xhafaj – Unë mendoj se duhet të them dy gjëra, sepse u ngritën disa pyetje që kërkojnë përgjigje.

Së pari, u tha që ne kemi pasur një projekt dhe e kemi ndryshuar atë për të arritur në një zgjidhje konsensuale. Është e vërtetë që ka pasur një projekt, por, për të qenë të saktë, ishte një projekt që ndryshonte cilësisht jo momentin e përzgjedhjes, por momentin e zgjedhjes, që do të thotë se me projektin që kishim para datës 21 korrik, Kuvendi vendoste drejtpërsëdrejti mbi përzgjedhjen e grupeve të interesit dhe, nëse nuk arrinte të vendoste, zgjidhej një prej atyre që vendosnin grupet e interesit. Pra, nuk kishte një hallkë vendimmarrje të Kuvendit për procesin e zgjedhjes, si përzgjedhja, ashtu edhe zgjedhja në një farë mënyre, ishin të diktuar nga vullneti i grupeve të interesit, që në vlerësimin tim, edhe sot të më pyesësh, mendoj se ka qenë një gjë shumë pozitive, sepse ka qenë apolitike. Pra, ky ka qenë thelbi i atij projekti.

Çfarë u ndryshua nga ai projekt? U vendos që Kuvendi, partitë dhe grupet parlamentare të kishin një rol më aktiv në procesin e zgjedhjes.

Çfarë ka thënë Kushtetuta?

Kushtetuta e ka thënë në dy momente.

Në momentin e parë ka thënë që, bazuar në një procedurë transparence publike, është sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ai që shpall vendet vakante sipas ligjit.

Është në ligj kjo? Po, gjithë kjo procedurë është e qartë në ligj.

Ku është momenti i dytë i Kuvendit? Është te zgjedhja.

Kush i zgjedhë këta? I zgjedhë një trupë deputetësh. Asnjë gjë nuk lëviz nga pika 5, që parashikon zgjedhjen, rolin e Kuvendit dhe të partive politike, është e paprekshme, nuk mund të cenohet ajo, këtë e dimë dhe e kemi të qartë të gjithë dhe ky projekt nuk e cenon këtë. Pra, kompromisin e arritur, që procesin e hap sekretari i Përgjithshëm dhe procesin e zgjedhjes e mbyllë një trupë e nominuar nga Kuvendi, është kushtetuese dhe nuk e prek. Por Kushtetuta ka thënë që i gjithë ky proces të rregullohet sipas ligjit dhe ka ardhur ligji që ta rregullojë. Ku janë mbështetur ekspertët, për të cilët duhet ta kishit kursyer gjithë atë fjalor, si edhe duhet të keni më shumë respekt për punën e jashtëzakonshme që kanë bërë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ekspertët janë mbështetur në pikën 16 të Komisionit të Venecias, ku thuhet qartë se e gjithë kjo reformë ka pasur mbështetje të jashtëzakonshme të ekspertizës së Komisionit të Venecias dhe keni thënë të gjithë që ne i qëndrojmë Komisionit të Venecias. Në pikën 16, Komisioni i Venecias ka thënë shprehimisht që procesi i nominimit dhe i kandidimit, pra këtë që rregullon ligji, ky është proces kandidimi dhe jo proces zgjedhje, ky është po aq i rëndësishëm sa metoda e zgjedhjes së tyre. Cila është metoda e zgjedhjes? Është kjo me pesë deputetët.

Cili është procesi i kandidimit? Është ky që thotë qartësisht Komisioni i Venecias, ku thotë: distanca e tyre nga politika mund të figurohet nëpërmjet procesit të hapur dhe transparent nominimi me nismën e organeve të pavarura nominuese (universitete, OJQ, dhoma avokatie e të tjera) dhe të përfundohet nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, që përbëhet nga anëtarët e gjyqësorit. Ne e hoqëm Këshillin e Emërimeve në Drejtësi dhe vumë grupin e deputetëve, rolin që bënte Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, tani e bën grupi i deputetëve me sekretarin e Përgjithshëm. Ky proces nominimi duhet të bëjë të mundur që parlamenti të detyrojë të bëjë një përzgjedhje mes kandidatëve më të kualifikuar dhe jo të emëruarve politikë. Pra, procesin e zgjedhjeve, jo vetëm e kontrollon, por e dikton parlamenti.

Dikush nga ju tha që të ketë rol opozita. Po, zotëri, opozita ka rol aq sa maxhoranca nuk zgjedh dot asnjë nga këta pa mirëkuptimin e opozitës, sepse i duhen katër vota.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në zgjedhje, është këtu. Pra, maxhoranca jonë, megjithëse mund t'i ketë votat në parlament, nuk zgjedhë dot pa pëlqimin tuaj, e ka thënë qartazi, më katër vota.

E para, ky është një proces më transparent, sepse i hapë rrugë këtij parashikimit të Komisionit të Venecias, që është një parashikim shumë i rëndësishëm parimor. Ne, ashtu edhe ju, e kemi konsideruar Komisionin e Venecias busull të gjithë këtij procesi.

Ka edhe diçka tjetër që duhet të jemi të vetëdijshëm, që Komisioni i Venecias ka futur të famshmin short, që të them të drejtën, edhe ju disa herë nuk keni qenë shumë dakord, por ju e keni propozuar këtu, në këtë tavolinë, në dokumentet e para të opinionëve tuaja. Çfarë do të thotë? Pa një procedurë përzgjedhjeje kualifikuese vlerash, shorti është rastësi, kurse kështu kemi mundësi që të jenë vlerat më të mira brenda strukturave përkatëse. Unë mbetem përsëri jo partizan i shortit, por kështu është vënë në Kushtetutë, dhe, në qoftë se Kuvendi nuk arrin dot ta zgjedhë me 2/3-at, atë që do të vendosim ne, po arritëm dot të biem dakord me katër vota, përfshirë edhe votat e opozitës, në fund fare hidhet shorti që është një gjë rastësisht. Pra, ky lloj filtri shkon në pajtim me nevojën për të pasur një proces sa më pak politik, një proces ku i jepet shumë rëndësi përfaqësimit të grupeve të interesit, që sot janë aktorë të rëndësishëm të procesit të sistemit të drejtësisë, që u jep vlerë cilësive dhe konkurrencës së cilësive, jo anës formale të procesit, por konkurrimit të cilësive. Të gjitha këto e bëjnë procesin transparent, cilësor dhe nuk e prekin në asnjë germë kompromisin e 21 korrikut të jetësuar në normën kushtetuese. Aludimet që dëshironi t'i përdorni këtu si në konferenca shtypi, mendoj që duhet t'ia kishit kursyer, jo vetëm këtij komisioni dhe njerëzve të nderuar që janë ulur aty, por duhet t'ua kishit kursyer edhe grupeve të interesit, sepse unë nuk besoj se duhet t'i quani të gjithë ata pedagogë që do të votojnë... Duhet të kuptohemi, sepse ndonjëherë nuk e ka parë me vëmendje, ndoshta i ka shpëtuar, por nuk votojnë rektorët, votojnë pedagogët për kolegët e tyre, votojnë të gjitha dhomat e avokatisë së republikës për kolegët e tyre, një super proces transparent. Besoj se jo të gjithë këta nuk janë të kapur, sepse do të ishte fyese po të mendonim se të gjithë janë të kapur. Ky është

një proces më se transparent, që e respekton strikt Kushtetutën dhe Komisionin e Venecias dhe kësaj i përmbahen edhe kolegët e nderuar të ekspertizës ndërkombëtare, për të cilët besoj që...

Arben Ristani – Votojnë drejtues të institucioneve të arsimit të lartë.

Fatmir Xhafaj – Dakord, lexoje nga fillimi, sepse ti e lexon në fund gjithmonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, por propozimet vijnë nga pedagogët e fakulteteve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, të gjithë, sepse s'e ke parë, të kanë dhënë vetëm një nen ty.

Dakord, se nuk ta mësoj dot ligjin ty.

Për ta përmyllur, mendoj që projekti që kemi këtu, në vlerësimin tim, ka parasysh germën e Kushtetutës, frymën e Kushtetutës dhe rekomandimin e Komisionit të Venecias, që është një rekomandim më se i qartë dhe i detyrueshëm për t'u reflektuar.

Petrit Vasili – Një pyetje shumë të thjeshtë, për të davaritur edhe keqkuptimin.

Në mënyrë të vazhdueshme kemi avokatët, ku bëhet vlerësimi i kushteve të tyre, nëse i plotësojnë ato apo jo dhe vazhdojnë garën.

Edhe ata dhjetë që zgjidhen, se si zgjidhen nuk ka rëndësi, por vijnë prapë dhe verifikimin e kushteve të tyre e bën përsëri sekretarja e Përgjithshme.

Fatmir Xhafaj – Dhe vetë komisioni.

Petrit Vasili – Edhe komisioni... Tri filtrat.

Kjo nuk është punë filtrash. Nuk e di për çfarë arsye e bëjmë *ripetitiv* në ligj, sepse verifikimi, i përmbush apo jo kushtet bëhet një herë, por të verifikojë tri herë nëse i përmbushë apo jo kushtet, kjo do të thotë që ne kemi ndërtuar një sistem të paqëndrueshëm që nuk e besojmë, të cilit i bëjmë filtra fiktiv për ta çuar përpara. Se cila është etapa ku verifikohen kushtet, duhet ta përcaktojmë një herë e mirë dhe ne i kemi dhënë përgjegjshmëri të plotë ligjore që ta bëjë këtë punë dhe ne e besojmë, sepse në fund do të vijë puna dhe do të themi që filtrin e fundit do ta bëjë komisioni. Ta besojmë? Pra, duhet edhe një i katërt.

Kështu që, çështja parimore e vlerësimit të kushteve ka një *ripetivitet*, i cili nuk është logjik. Po të shkojmë ne ta shpjegojmë në opinion publik, edhe njeriu më i zakonshëm do të na zërë në këtë pikë. Në qoftë se hap një procedurë kandidimi, që

kandidojnë të gjithë dhe në fund fare këta zgjedhin, pavarësisht se si janë, vetëm me një set kushtesh specifike për ta, por që nuk është vlerësimi, ai mund të ishte një truk, nuk e besoj shumë, por mund të ishte një truk.

Por, pasi vlerësoj kushtet unë, Ulsi dhe Vasilika, janë të vërteta, ligji i ka dhënë në mënyrë të drejtë, edhe në rast se unë nuk i vlerësoj drejtë kushtet, vendimi im apelohe, por është një instancë që vlerëson kushtet. Në qoftë se ka tjetër, ose hap garën, hap mundësinë dhe ec përpara. Unë them që t'u ikim lajthitjeve të tilla, për veten tonë, sepse s'do ta besojnë. Ne nuk bëme reformë që të bëjmë tri filtra, por bëme reformë që kemi një filtër, na funksionon shpejt dhe mirë dhe davarisim tërë këto keqkuptime që kemi.

Më fal, Vasilika!

Së dyti, që ta mbyll, sepse s'dua t'ju marr kohë.

Ne kemi një gjë për të cilën ekspertiza ndërkombëtare duhet të jetë shteruese në këtë pikë, sepse ne kemi tri kategori që zgjidhen, siç thamë që avokatia zgjedh fakultetet dhe pastaj shoqëria civile. Ndërkohë që të gjithë kemi një gabim parimor në qoftë se fakultetet nuk i konsiderojmë shoqëri civile, sepse në të gjithë botën baza e shoqërisë civile vjen nga fakultetet, vetëm në Shqipëri janë ndarë që fakultetet janë fakultete dhe shoqëria civile është në krahun tjetër. Hajde të ecim edhe në këtë rrugë që na bën qesharakë, por ne qesharake jemi bërë në shumë gjëra.

Fatmir Xhafaj – E ka Kushtetuta, s'ke çfarë i bën.

Petrit Vasili - Në teori shoqëria civile është dimensionimi më i gjerë që shoqëria prodhon, ndërsa kategoritë e tjera i gjejmë gjithmonë më të kufizuara, prandaj është e preferuar shoqëria civile, për gjerësinë, për spontanitetin dhe pavarësinë e dhënies së mendimit. Në të njëjtin ligj, nuk duhet të kthejmë përgjigje ne, sepse nuk ia mbushim dot mendjen njeri-tjetrit, por të na kthejnë përgjigje të huajt. Ne kemi përdorur këto tri kategoritë, dy kategori kemi dhënë mundësi për të zgjedhurat, për dy kategori më të kufizuara në teori, pasi shoqëria civile është shumë më e gjerë, sepse shoqëria civile mbush sheshe, nuk i mbushin avokatët dhe kemi lënë një pikë që themi që këtë procedurë e kryen Kuvendi, për dy të tjerat kemi përcaktuar procedura për zgjedhje brenda. Jo ne, por ekspertiza e huaj duhet të na thotë që edhe ne të kemi mundësi t'ua themi njerëzve përjashta, që ne e kemi marrë këtë vendim këtu, sepse kishim këtë bindje, që e bëme këtë

përrjashtim, që më të madhen e lamë të lirë, kurse më të voglën e vumë me zgjedhje, sepse normalisht më e madhja duhet të ishte me zgjedhje dhe më të voglat duhet të ishin më përcaktim. Pra, kemi një kriter, i cili ecën deri diku dhe thyhet në një vend. Por mbi ç'bazë e kemi thyer? Nuk mund të themi mbi bazën e mosbesimit, sepse dëgjova shumë këtu për rrezikun e kapjes nga politika, jo, sepse kemi ndryshuar Kushtetutën dhe sistemin në bazë të vullnetit të politikës. Ne nuk jemi këtu një tufë me njerëz pa identitet dhe pa karakter dhe kështu do të jetë edhe politika në të ardhmen, prandaj ne po përcaktojmë disa mekanizma se politika bën lobime. Jo, ne kemi ecur mbi vetëdijen që vetëdija e të gjithëve rritet. Edhe ata që zgjedhin avokatët, të mos zgjedhin zuzarë, pavarësisht se krijojnë kushtet ligjore, por edhe profesorët të mos bëjnë klientelizëm me njëri-tjetrin, të na bien ata që u pëlqejnë më shumë, që është super klient dhe ne të jemi të përgjegjshëm, sepse ne kemi një sistem përgjegjshmërie që ngrihet në të gjitha nivelet, jo që politikanët të vazhdojnë të mbeten të papërgjegjshëm dhe të pandershëm dhe pjesa tjetër e shoqërisë të pastrohet. Kështu që, unë them që kot shpenzojmë debat me këto gjëra, por na mjafton një shpjegim shterues nga një ekspertizë ndërkombëtare, atë kemi zgjedhur për arbitër dhe të vazhdojmë më tutje. Ti lemë retorikat që bëjmë ne me njëri-tjetrin, asnjëra palë nuk ia mbush dot mendjen tjetrës. Kjo është e qartë. Në këtë mënyrë edhe marrim shpjegime. Dakord, të paktën qetësohemi që e morëm diku më të paanshëm dhe të vazhdojmë të ecim, sepse me këtë ritëm nuk bëjmë dot përpara.

Fatmir Xhafaj – Dakord! Faleminderit, zoti Vasili!

Zoti Bylykbashi e ka fjalën.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti kryetar.

Faleminderit edhe zotit Vasli për nënvizimin e këtyre elementeve! Sigurisht, dolët edhe më përpara.

Po jua them duke i parë në sy ekspertët se këto propozime shkelin haptazi edhe Kushtetutën, edhe konsensusin politik që kishim për këtë Kushtetutë. Edhe unë kam qenë dikur në atë karrige dhe sot jam në këtë karrige, dikur nuk mbaja asnjë lloj përgjegjësie për atë që thosha, përveç asaj që ishte ana ime profesionale, ndërsa sot kam përgjegjësi publike edhe me votë, dhe në fund fare, pasi të keni mbaruar ju fjalën, kam përgjegjësi për këtë që do të bëjmë. Ju do ta mbaroni dhe ne do ta vazhdojmë. Kështu që, merreni si

ta keni, lehtë ose rëndë këtë që po them, por ju keni përgjegjësi shumë të madhe nëse kjo do të shkojë në këtë formë. Ky është konstatim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Majko, po flas unë dhe e marr unë përgjegjësinë për fjalët që po them. Në atë tryezë ka edhe individë që kanë përgjegjësi edhe për moszbardhjen e plotë dhe të saktë të amendamenteve kushtetuese në përputhje 100% me marrëveshjen politike, e cila është e dokumentuar me email-e me orë përpara miratimit përfundimtar dhe tregojnë që ishte rënë dakord për tjetër gjë. Unë sot kuptoj gjithmonë e më tepër ndarjen e madhe dhe insistimin e madh të kësaj maxhorance për ndarjen e grupit të ekspertëve, në grupin e ekspertëve të nivelit të lartë dhe ata të opozitës që janë vetëm për të këshilluar opozitën. Të gjitha këto janë shumë të rënda dhe mua më vjen shumë keq që më duhet t'i them këto. Jua thashë që edhe unë dikur kam qenë i ulur në atë tryezë. Nuk e di se sa jeni të ndërgjegjshëm dhe se jeni të kapur tek objektivat e dikurshëm të reformës në drejtësi, të cilat qartazi janë objektiva të njëanshme të reformës në drejtësi dhe të paflektuar në ndryshimet kushtetuese, por për sa i përket kësaj që po flasim, ndryshimi është i pastër, neto, ajo që ju kishit propozuar dikur u ndryshua. Kishit parashikuar një proces me parafiltër propozues, dominues, siç e tha me të drejtë kryetari, pra nuk ishte e drejtë...

Fatmir Xhafaj – Nuk e thashë unë, e thotë Venecia, unë citova Venecian.

Oerd Bylykbashi – Nuk ishte e drejtë e çdo shtetasi avokat, pedagog i të drejtës, apo nga kjo kategoria e përgjithshme e papërcaktuar e shoqërisë civile, por ishin këto organe që bënë propozime, ashtu si për shembull Presidenti i Republikës bënte nominim në parlament për të vazhduar një proces përzgjedhesh. Kjo ndryshoi thelbësisht, pra ishte trupa nominuese dhe parlamenti si trupë përzgjedhëse. Me një vendimmarrje politike konsensuale e gjithë kjo ndryshoi në mënyrë thelbësore dhe jo në mënyrë të rastësishme, dhe në këtë botë politike, besoj se kjo vlen edhe për ekspertët, *“Pacta sunt servanda”*, dhe që të mos ndodhte që ne të bënë këtë lloj debati, kjo u shkrua, por ne prapë po e bëjmë këtë debat, sepse ju thoni që është kështu. Ju mendoni që keni parë diçka tjetër që ne nuk e shohim, ose, kur ju themi që ka antikushtetueshmëri, ju thoni që nuk e shohim antikushtetueshmërinë. Në maksimumin e asaj që ne do të kuptonim se kishte një lloj marzhi për ju ekspertët, në fund të fundit, edhe ne kemi mjaft ekspertizë për të bërë të njëjtin rol që po bëni ju sot. Mundet që atë kornizë të hekurt që ka përcaktuar Kushtetuta

ta detajonit brenda saj, por pa shtuar gjëra të ndryshme, madje edhe të çuditshme, si për shembull “mbledhja e drejtuesve të fakulteteve”, e keni vënë me germa të mëdha për të krijuar një entitet. Në një rast kur ka dashur ta bëjë Kushtetuta, ka qenë Konferenca Kombëtare Gjyqësore, e përcaktonte të shkruar në Kushtetutë, por e kishte bërë kushtetutbërësi. Kësaj radhe kjo nuk është, por ju keni gjetur lirinë e madhe në një sinkroni shumë të madhe, me një qëndrim të vjetër politik për ta bërë këtë gjë dhe unë nuk ia shoh jo vetëm bazën kushtetuese, por e gjej edhe të papranueshëm politikisht këtë lloj propozimi. Po jua them duke ju parë drejtpërdrejt, nuk e kam fare problem se çfarë po them, sepse të gjitha këto mbeten të shkruara dhe do të lexohen edhe pas 10 vjetësh. Nëse do të kishit detajuar ndonjë gjë që do të ishte më e mirë për rrjedhshmërinë e punës, nga hapja e kandidaturave deri në zgjedhjen e anëtarëve jogjyqtarë apo joprokurorë, do ta pranoja dhe do të thosha shumë mirë, por, duke krijuar pjesë të procesit që nuk janë, kjo është antikushtetuese. Në mënyrë të qëllimshme kemi vendosur ta sjellim të gjithën brenda në Kuvend dhe këtë qëllim as ekspertët nuk e ndryshojnë dot, politika mund ta ndryshojë në mënyrë të njëanshme, siç do të ndodhë këtu sot, sepse për sa kohë u thye konsensusi që Kushtetuta dhe tekstet e ligjeve do të dakordësoheshin së bashku para miratimit të tekstit kushtetues, kjo do të ndodhë, nuk ka se çfarë të ndodhë tjetër. Është e vjetër shprehja brezhnëviane “çfarë është e imja, është e imja dhe çfarë është e jotja negociohet” dhe kjo po ndodh sot. Sekretari i Përgjithshëm një funksion jopolitik, përtej se çfarë mund të mendojë ndonjë anëtar këtu, por kështu e kemi përcaktuar ne sot në ligj, edhe në Kushtetutë në rastin konkret, është një funksion që do të shërbejë për filtrin jopolitizues. Pra, nuk do të vendosim ne politikanët nëse personi x i plotëson apo jo kushtet. Jo, madje na është dhënë e drejta për të bërë një moment apelimi të një shkelje të drejte eventuale, për arsye ndoshta jo të qëllimshme, por me katër vota ne i rikthejmë të drejtën dikujt që i është mohuar me pa të drejtë, sepse kjo është brenda Kuvendit. Kjo është e shkruar në Kushtetutë dhe ju kur e shkruani ligjin nuk keni ku t’i shpëtoni që të na hiqni këtë të drejtë, por ama na keni hequr plotësisht të drejtën me propozimin që po bëni dhe e mbështesni këtu sot, që t’i rikthejmë të drejtën dikujt, të cilit i është mohuar gjatë seleksionimit të kandidaturave për nominim në Kuvend. Ku do të ankohen ata? Nuk ka se ku, sepse keni parashikuar një proces që është ekstra kushtetues, por, gjithashtu, për të njëjtën arsye është antikushtetues. Keni ngritur një proces të tërë zgjedhor, ndërkohë që

kushtetuta parashikon që kjo zgjedhje ndodh në Kuvend, ndërsa ju e keni parashikuar të gjithin jashtë. Për të gjetur lirinë që të shtoni në ligj, keni shfrytëzuar jo kriteret, por procedurat dhe organet e reja, duke gjetur frazën e paragrafit 4, ku thuhet: “sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në një procedurë transparente dhe publike”, dhe Kuvendi i ka rregullat për të bërë diçka të tillë, “shpall vendet vakante sipas ligjit.” Pra, shpallja e vendeve vakante bëhet sipas ligjit, nuk ndryshohet asnjë procedurë, nuk shtohet, asnjë organ nuk vendoset dhe ka asnjë kriter shtesë, por shpallja bëhet sipas ligjit dhe të gjithë shtetasit e Republikës së Shqipërisë që janë avokatët, pedagogë të së drejtës dhe nga shoqëria civile që janë juristë, kanë të drejtën të konkurrojnë të lirë. Nëse sekretari i Përgjithshëm u shkelë të drejtën, ia rikthen Kuvendi me katër vota dhe nënkomisioni me katër vota. Këtë ka parashikuar marrëveshja politike dhe Kushtetuta e shkruar mbi bazën e marrëveshjes politike, për të cilën ne ishim dakord, edhe pse jo e zbardhur 100% për faj të dikujt tjetër. Kështu që, të vini të na thoni thjesht dhe vetëm se jeni ulur si ekspertë, e thashë edhe një herë, dikur jemi ulur të gjithë në atë tryezë, kemi mbajtur kokën ulur me respekt përpara komisioneve parlamentare, por kjo nuk kualifikon fare që ajo që po thoni ju është e vërteta dhe është ndryshe. Unë i kuptoj kolegët e mi, sepse kanë qëndrime të ndryshme në pozicionet e tyre, por ju nuk ju kuptoj. Me atë që ju bëni, keni hequr themelin e procedurës që parashikoi marrëveshja dhe u kthye në Kushtetutë, elementin politik në përzgjedhjen midis buqetës së plotë, të hapur dhe të kualifikuar të të gjitha kandidaturave. Me çfarë të drejte e bëni ju këtë? Me cilën të drejtë i jepni ju Dhomës së Avokatisë mundësinë që në 11 avokatë të kualifikuar si të zotët, njërin ta lini jashtë? Pse? Pse Kuvendi të mos ketë mundësinë që të 11-ët, 12-ët, apo të 100 avokatët të jenë në dispozicion të tij, që Kuvendi të bëjë zgjedhjen më të mirë? Ju nuk mund të ankoheni se ka një mekanizëm që është politik, mblidhen pesë përfaqësues të politikës dhe nxjerrin një listë, jo ju këtë nuk e bëni dot, sepse kështu kemi vendosur ne, domethënë kushtetutbërësit, sepse ne këtu nuk jemi kushtetutbërësi, por ju nuk shkoni dot dhe ta kapërceni këtë. Jua thashë edhe një herë që është unike, lapidare dhe do të përcaktojë një precedent jashtëzakonisht të keq për ekspertizat në të ardhmen. Në qoftë se Kuvendi ka vendosur që të ketë këtë dozë politike për të dërguar përfaqësuesit e tij në këtë organ, siç është KLGJ-ja dhe KLP-ja, që të mos ketë korporatizëm gjyqtarësh apo prokurorësh, e ka ndarë Kushtetuta dhe ju nuk mund ta zhbëni këtë, pavarësisht

objektivave të vjetra strategjike që sot askujt nga ne nuk na përkasin, sepse është ndarë në Kushtetutë. E theksoj, jemi përpara një procesi kandidimi shtetasish shqiptarë. Kriteret i ka ndarë Kushtetuta dhe nuk keni asnjë lloj të drejte ju dhe ne këtu që ta ndryshojmë këtë dhe ta kthejmë në një proces nominimi, qoftë edhe të 10 personave. Me të drejtë, zoti Vasili tha: po ç'është kjo me dy standarde, ata që janë pak i bëni edhe më pak dhe ata që mund të jenë pafund i lini hapur komplet? Si e bëni këtë? Pse në një pikë ju respektoni Kushtetutën dhe aty ku doni e bëni ndryshe? Kushtetuta nuk e jep këtë hapësirë. Kështu që, duke ju parë edhe një herë në sy po ju them: me këto propozime dhe qëndrimin tuaj, po cenoni atë që është arritur në konsensus edhe me praninë e përfaqësuesve të lartë diplomatik në këtë sallë dhe po bëni propozime që shkelin Kushtetutën. Referimi te paragrafët e Komisionit të Venecias, që ka parë dikur në shtator apo në janar draftin tuaj të vjetër, është shprehur për ato, por jo për këtë. Diskutimi aq i gjatë për paragrafin 88, që çoi në atë nevojë për marrëveshje politike është mbi ju, nuk kemi ç'bëjmë. Kjo është zgjidhja dhe ju nuk e ndryshoni dot. Maxhoranca e ndryshon me arrogancën që thotë se ne bëjmë siç mendojmë ne, shkoni në Gjykatë Kushtetuese, por ju ekspertët nuk e bëni dot.

Fatmir Xhafaj – Po.

Vasilika Hysi –Faleminderit, zoti kryetar!

E dëgjova me vëmendje të gjithë diskutimin e kolegëve të maxhorancës dhe të opozitës. Do të doja të sillja në vëmendje pse ky nen, pra neni 3, është lënë i hapur dhe për t'u ndryshuar në varësi të ndryshimeve kushtetuese. Ne kemi qenë të detyruar të reflektonim një nga rekomandimet e paragrafit 88 të Komisionit të Venecias. Çfarë thotë në paragrafin 88 Komisioni i Venecias? Komisioni i Venecias në paragrafin 88 ka folur për mënyrën e votimit, për shumicën e cilësuar, të kërkuar për anëtarët jogjyqtarë në katër trupat e mëdha, në Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Këshillin e Kualifikimeve dhe në strukturat e tjera. Këtu nuk është folur, nuk është atakuar dhe nuk i është lënë detyrë këtij parlamenti mënyra e nominimit, por vetëm e votimit.

Në paragrafin 88 të Komisionit të Venecias thuhet: “nëse palët në procesin politik nuk pranojnë shumicën e cilësuar të kërkuar për anëtarët jogjyqtarë, ata mund të zgjedhin një sistem proporcional, që garanton përfaqësimin e opozitës mes organeve kolektive, ose çdo model tjetër të përshtatshëm që do të siguronte ndikimin e opozitës në

procesin e zgjedhjes.” Më 21 korrik, grupi negociator zgjodhi formulën që të garantojë ndikimin e opozitës në procesin e zgjedhjes dhe kjo reflektohet shumë mirë në nenin 147 të Kushtetutës. Pra, hoqëm Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, i cili rendiste kandidatët jogjyqtarë dhe i hoqëm mundësinë parlamentit që nëpërmjet votimit me shumicë të cilësuar, në qoftë se nuk arrinte të përzgjidhte kandidatin quhesh i emëruar automatikisht, i pari i renditur në listën e Këshillit të Lartë të Emërimeve, por nëpërmjet një formule i dhamë mundësi opozitës që të ndikojë në përzgjedhjen e anëtarëve jogjyqtarë.

Kolegët thanë që pse ka kaq shumë filtra? Edhe unë them që ka shumë, por unë jam e detyruar të respektoj Kushtetutën. Çfarë thotë neni 147 i Kushtetutës? Neni 147, nga paragrafi 3 deri në paragrafin 7 flet për përzgjedhjet, zgjedhjet, vlerësim të kriterëve formale dhe vlerësim të mëtejshëm dhe përzgjedhje të kandidatëve në Kuvend. Ajo që thotë zoti Bylykbashi, që ne nuk kemi të drejtë të përcaktojmë kriteret shtesë, që duhet të plotësojnë kandidatët, bie ndesh me përcaktimet Kushtetuese, sepse në nenin 147 të Kushtetutës në paragrafin e tretë, fjalia e fundit, thuhet: “kriteret të tjera”, pra përcaktohen me ligj.

E dyta, zoti Bylykbashi tha që nuk mund të përcaktohen procedura për përzgjedhje të kandidatëve. Jo, edhe kjo thënie, që uroj të jetë lapsus nga zoti Bylykbashi dhe të mos e ketë lexuar nenin 147 paragrafin 3 të Kushtetutës, nuk qëndron. Pse? Përsëri po citoj: neni 147 paragrafi 3, fjalia e fundit thotë: procedura për përzgjedhjen e kandidatëve rregullohet me ligj.

Gjithashtu, pati një diskutim, meqenëse sekretari i Përgjithshëm bën verifikimin e kushteve, pse duhet ta bëjë edhe nënkomisioni? Po të mos ishte kjo Kushtetutë, ndoshta do të ishte më mirë të kishim një kriter, një filtër, jo vlerësim pas vlerësimi.

Shikoni çfarë thotë pika 5 e nenit 147 të Kushtetutës: sekretari i Përgjithshëm vlerëson plotësimin e kushteve dhe kriterëve për t’u zgjedhur, ndërsa pika 6 thotë: sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, pas përfundimit të verifikimeve i dërgon menjëherë nënkomisionit listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale. Pra, sekretari i Përgjithshëm e ka bërë një filtër.

Se çfarë bën nënkomisioni e thotë pika 7 e nenit 147 të Kushtetutës: Komisioni i përhershëm përgjegjës për Çështjet Ligjore në Kuvend krijon një nënkomision për vlerësimin e mëtejshëm dhe për përzgjedhjen e kandidatëve. Pra, është Kushtetuta që na e

ka kërkuar, që, pasi të kemi një proces nominimi transparent, pluralist dhe gjithëpërfshirës, të cilin e pasqyroj dhe e përshkroi shumë mirë kryetari i komisionit, kemi një mundësi që të përcaktojmë kritere të tjera shtesë dhe jemi të detyruar ta bëjmë. Unë jam dakord me shumë nga kriteret që ju keni propozuar, që do t'i diskutojmë dhe që do t'i përfshijmë në nenet e tjera dhe këtu nuk shkelim Kushtetutën, zoti Bylykbashi, që thoni se nuk kemi të drejtë, sepse këtë drejtë, ju, mua dhe të gjithë komisionit na e jep pika 3 e nenit 147. Ne kemi detyrimin të përcaktojmë procedura për përzgjedhjen, të detajuara në ligj. Jemi në detyrime kushtetuese të pikës 3 të nenit 147, por njëkohësisht si anëtarë të nënkomisionit, kushdo nga ju, edhe unë të jem, po të jemi anëtarë të nënkomisionit kemi për detyrë që, pavarësisht se sekretari i Përgjithshëm do të bëjë një vlerësim të kriterëve formale, do të vazhdojmë të bëjmë vlerësimin e mëtejshëm dhe përzgjedhjen e kandidatëve para se t'ia çojmë seancës plenare. Pra, ajo që është diskutuar si pjesë e negociatave të 21 korrikut, nuk ka të bëjë me procesin e nominimit, por ka të bëjë me rolin e opozitës në votim dhe kjo është nëpërmjet një komisioni proporcionaliteti që u krijua me përbërje nga anëtarë të shumicës, pakicës parlamentare dhe me një mekanizëm se si do të votohet lista e konsoliduar dhe si mund të hidhet poshtë ajo.

Unë jam dakord me shqetësimin që ngriti zoti Vasili, që pse ka qaq shumë përzgjedhje. Këtë mund ta kishim diskutuar para se të miratohej Kushtetuta, por me atë kompromis që sollën kolegët më 21 korrik, ku janë futur tri lloj filtrash që fillojnë nga nenin 3 e në vijim, nuk mund t'i kthehemi më mbrapsht.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Kruja!

Keltis Kruja – Faleminderit!

Kushtetutën e kemi të gjithë përpara dhe ashtu siç e lexoi zonja Hysi, ashtu e lexojmë edhe ne. Kushtetuta ka dy filtra, nuk ka tri dhe ne nuk diskutuam fare as për filtrin e sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, i cili është i parashikuar në Kushtetutë, as për nënkomisionin, i cili edhe ai është i parashikuar në Kushtetutë, por themi pikërisht këto që thoni ju, që të zbatohet Kushtetuta me filtrat që përmban.

Unë kam një pyetje.

Së pari, kur këto filtrat i ka parashikuar Kushtetuta, pse duhet ne të kemi filtra të tjerë?

Së dyti, si mund të jetë filtrues një organ, i cili merr vendim, voton mbledhja e përgjithshme e Dhomës së Avokatisë, votojnë të gjithë avokatët për ta? Pra, praktikisht nuk kemi zbatim, vlerësim apo kualifikim në bazë të kritereve formale që duhet të plotësojnë kandidatët, kështu thotë Kushtetuta, por kemi votim, i cili në rastin eventual mund të përjashtojë disa kandidatë që mund të jenë shumë më të mirë sesa ata që dalin nga votimi, sepse kushtetutbërësi, që të gjithë ne e kemi votuar, diskrecionin e vendimmarrjes ia ka lënë Kuvendit dhe askujt tjetër. Nuk mund të ketë kuvende të tjera, pleqësi të tjera, që përpara se të votojë Kuvendi, të na votojnë dhe të na sjellin një vendim për 10 kandidatë që janë më të mirë. E përsëris edhe një herë, ky parashikim nuk mund të ketë 10 nene të ligjit që flasin për kuorum, për lista votimi, për proces votimi, për proces të numërimit të votave dhe pastaj edhe për ankimim kundrejt procesit të numërimit të votave dhe ne ta quajmë nominim, apo proces përzgjedhës, të paktën për këtë të jemi të ndershëm me njëri-tjetrin. As Kodin Zgjedhor nuk e kemi kaq të detajuar për zgjedhje, sa ç'kemi detajuar këto nene të këtij ligji. Mos e difuzojmë fare problemin. Thirrja për ndihmë e opinionit të Komisionit të Venecias nuk është fare e ndershme, sepse, në bazë të opinionëve të Venecias, ne kemi miratuar Kushtetutën, dhe, për sa kohë që ne kemi një Kushtetutë të miratuar, edhe mbi bazën e një marrëveshje politike, sepse në fund të ditës është kontratë sociale mes shqiptarëve, ne nuk mund të thërrasim në ndihmë as opinionet që kanë qenë në ndihmë të miratimit të Kushtetutës dhe aq më tepër t'i përdorim këto opinione për t'iu kthyer kundër Kushtetutës. E thashë, në qoftë se jeni bërë pishman për marrëveshjen dhe Kushtetutën, kjo është çështje tjetër, është politike. Ne këtu po diskutojmë se si të bëjmë sa më mirë një ligj, i cili do të jetë një nga ligjet themelore të kësaj reforme, që ka të bëjë edhe me qëllimet që thanë ekspertët. Por që të nisesh nga qëllimet që paska pasur kjo reformë për të shkelur Kushtetutën, mua më duket pak e shtyrë në logjikë, në arsyetim teknik, profesional dhe politik. Nuk e di a e dëgjuat nënkryetarin e komisionit? Personalisht, unë do të doja që pas gjithë këtij debati politik dhe teknik që bënë kolegët në këtë komision, do të doja edhe një qëndrim të ekspertëve, lidhur pikërisht me këto çështje që ngritëm. Pretendimet tona, besoj se dolën shumë qartë, që këto nene haptazi i marrin kompetencën Kuvendit për të marrë vendim, kompetencë që nuk ia ka marrë Kushtetuta, por ua ka lënë edhe organeve të Kuvendit për të bërë

vetëm përzgjedhjen, ndërkohë që disa kuvende të tjera avokatore, apo pedagogjike votojnë pikërisht për kompetencën që ka Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Fatmir Xhafaj – Dakord, faleminderit!

Ka të tjerë? Jo, nuk ka të tjerë.

U ngritën disa çështje nga kolegë të maxhorancës dhe të opozitës. Ka një pyetje, nëse i merret apo jo kompetenca Kuvendit nga ky parashikim që keni bërë ju? A jemi në tejkalim të normës kushtetuese, apo jo? Së treti, kemi dy zgjidhje. Në rastin e avokatisë dhe të profesoratit kemi një zgjidhje, ndërsa në rastin e shoqërisë civile kemi një zgjidhje tjetër. a mund t'i barazojmë që të kemi një zgjidhje të unifikuar, a është e mundur dhe si mund të bëhet?

Zoti Ibrahim, zonja Bernhard, zoti Deville?

Gent Ibrahim – Faleminderit, zoti kryetar!

Natyrisht që diskutimi ishte shumë politik dhe kjo ishte e pritshme. Në një farë mënyre është e vështirë t'u përmbahesh komenteve thjesht teknike, por sigurisht që unë atë do të bëj, sepse s'mund të bëj asgjë tjetër. Leximi ynë i këtij neni është që paragrafi 3 flet për përzgjedhje dhe paragrafët nga 4-8 flasin për zgjedhje. Ne kemi zhvilluar paragrafin 3, atë të përzgjedhjes, i cili na autorizon qartë që të parashikojmë kritere dhe procedura për përzgjedhjen e kandidatëve dhe pikërisht këtë kemi bërë, në dhjetëra faqe kemi parashikuar kritere dhe procedura për përzgjedhjen e kandidatëve. E kuptoj që zoti Bylykbashi thotë që objektivi i vjetër i depolitizimit nuk qëndron më, por nuk besoj që, duke lexuar këtë nen, mund të arrish në këtë përfundim. Është i vetmi argument, të cilit nuk i jap dot përgjigje, prandaj jam i detyruar t'i qëndroj. Përgjigjen besoj se e dhashë, por e vetmja gjë të cilës nuk i jap dot përgjigje është kjo...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aldo Bumçi – Të nderuar ndërkombëtarë, duam një përgjigje. Nëse ju jeni dakord me këtë gjë dhe cilët janë argumentet?

Jo nuk e dua nga ti, e dua prej atyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gent Ibrahim – E kuptoj që nuk të mjaftojnë argumentet e mia, por vetëm dy minuta durim.

Fatmir Xhafaj – Zoti Bumçi, të lutem, sepse nuk je në seancë.

Gent Ibrahimi – Vetëm dy minuta të keni durim dhe do ta dëgjosh edhe nga goja e së vërtetës.

Fatmir Xhafaj – Ruaj respekt për ata, sepse kanë tri orë që po na dëgjojnë ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Dakord!

Gent Ibrahimi – Në lidhje me idenë që ka një zhbilancim në lidhje me procedurën që parashikohet për përzgjedhjen e kandidatëve, midis atyre që vijnë nga avokatia, grupi i pedagogëve dhe nga shoqëria civile, kjo është e vërtetë që ka një zhbilancim, sepse në thelb janë dy sisteme të kandidimit.

Të parin mund ta quaja sistem të kandidimit të kushtëzuar dhe të dytin sistem i kandidimit të pakushtëzuar. Është e vështirë që për momentin të jap një zgjidhje për unifikimin e tyre, por vetëm dy zgjidhje mund të jenë.

Zoti Vasili, po i përgjigjesha pyetjes suaj. Logjika është kjo, që, nëse dy grupet e para janë të organizuara dhe të përfaqësuara, është vërtet shumë e logjikshme që t'u besosh organeve përfaqësuese të atyre grupeve në një proces zgjedhor, i cili të përzgjedhë më të mirët. Një grup shoqëror, të gjerë, të padefinuar qartë dhe të paorganizuar në struktura qeverisëse, është më e vështirë që t'ia nënshtrosh një proces të tillë. Megjithatë, në rast se kjo është një gjë që kërkohet, ne mund të mendojmë një zgjidhje edhe për këtë grup, por për momentin nuk mund t'ia jap.

Oerd Bylykbashi – Zoti Ibrahimi, nuk po shtoj ndonjë gjë në lidhje me atë që tha zoti Bumçi.

Në fakt, të ngulësh këmbë me formulime që nuk ekzistojnë askund, nuk bën punë as ekspertiza për komisionin. Kemi shumë kohë që njihemi, edhe kemi punuar bashkë, kështu që e dini respektin tim, por nga një anë ndjehem keq kur dëgjoj gjëra që nuk qëndrojnë.

Kush nuk i thotë qartë historitë e kandidimit të kushtëzuar dhe të pakushtëzuar? Nuk e ndërroni ju këtë gjë.

Së pari, përtej objektivave politikë të vjetër, që kishte strategjia e reformës, nuk është më, ka ndryshuar.

Së dyti, nuk mund të vini dhe të na thoni që zgjedhja është te këta dhe përzgjedhja është...

Përzgjedhje nga fillimi deri në fund, për këtë flet.

Paragrafi tre thotë: “kriteret dhe procedura për përzgjedhjen e kandidatëve rregullohen me ligj”. Kjo është për pjesën e gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

Paragrafi shtatë thotë: nënkomisioni përzgjedh kandidatët me të paktën katër vota. Pra, kandidojnë të lirë, përzgjedhjen e bën nënkomisioni, ndërsa Kuvendi voton dhe zgjedh. Jo vetëm kaq, sepse nuk e thashë më parë, por, siç ishte përpara, është edhe tani, thua se Kushtetua nuk ekziston, po bëni edhe një gjë, që është shumë e rrezikshme, përtej asaj që është e vërtetë deri në fund. Pavarësisht qëndrimit stoik, po transferoni kapjen politike si problem përtej atij që mund ta mbajë këtë barrë, që është Kuvendi, po e ktheni dhe po korruptoni praktikisht edhe trupa të tjerë. Dhoma e Avokatisë do të jetë fushëbeteja e ardhshme e kapjes politike dhe ju këtë nuk e rregulloni dot. Mbledhja e drejtuesve do të jetë fushëbeteja tjetër e kapjes politike që ju nuk e rregulloni, mbase edhe nuk doni ta rregulloni. Çdo tentativë për të rregulluar ujërat e detit, siç është shoqëria civile, për t’i dhënë një kuorum, një trupë dhe për t’i dhënë procedura vendimmarrje, ju e kuptuat vetë që është e vështirë, sot nuk e bëni dot edhe këtu do të transferoni një problem korruptimi politik, përtej korruptimit tjetër lloj që ka kategoria. Po merrni përsipër një barrë shumë të madhe, jo vetëm që po ndryshoni Kushtetutën, por po transferoni problemin aty ku parlamenti nuk ka se çfarë bën më. Brenda vetes së vet e përballon, sepse ka ndërtuar një raport 3+2 te nënkomisioni, ka ndërtuar një vendimmarrje me një shumicë të cilësuar specifike, ka ndërtuar procedura zhbllokimi të kësaj. Në këtë sallë, me orë të tëra, përfaqësuesit më të lartë të Komitetit Ndërkombëtar kërkonin mekanizmin e zhbllokimit urgjent, që është ky, ndërkohë, ju e bëni nul, është zero, sepse po çoni atë ujë që duhet që nesër të mos ketë as bllokim, të mos ketë as diskutim. Pra, komisioni me pesë anëtarë, 3+2 të jetë irrelevant, germa e Kushtetutës të jetë vetëm një lëvozhgë, është marrë ndryshe dhe asnjë nga ju ekspertët nuk ka minimumin e tagrit për ta bërë këtë dhe ç’do lloj frazeologjie e padefinuar nuk ju ndihmon në këtë pjesë. Më vjen shumë keq që duhet t’jua them këtë, por po merrni përsipër diçka shumë të madhe, jo vetëm shkeljen e Kushtetutës, por po cenoni kompromisin politik të 21 korrikut.

Fatmir Xhafaj – Kompromisi është Kushtetuta.

Oerd Bylykbashi – Pikërisht, kjo që është e shkruar këtu. Siç e thashë, meqenëse për faj të dikujt në këtë sallë kompromisi është i shkruar jo saktë, megjithatë shumë mjaftueshëm, ky është i mjaftueshëm, kështu dakord jemi ne, por jo këtë që thoni ju, sepse është diçka tjetër, është ndryshe, është me shtesa. Nuk janë filtra, por janë devijim nga ajo që ishte parashikuar. Në seancën e votimit po kërkoni që të çoni të tjerë nga ata që do të dilnin nëse do të ishte ndjekur procedura e saktë. Po u hiqni të drejtën individëve të marrin pjesë dhe t'i nënshtrohen Kuvendit, sepse dikush tjetër që mendoni ju, është më i mirë sesa sekretari i Përgjithshëm, nënkomisoni ad-hoc dhe Kuvendi vetë, i hiqni mundësinë që të kandidojnë. Ju i limitoni, janë 100 kandidatë shumë të mirë dhe ju çoni 10, po 90 të tjerët ku e kanë të drejtën?

Gent Ibrahimi – Po të mos ishte kufizuar numri, do të ekzistonte problemi?

Oerd Bylykbashi – Nuk ka fare rëndësi, sepse e ka marrë përsipër Kuvendi ta zgjidhë këtë problem, ku do të mbledhen 5 burra dhe gra dhe do të dalin 5 emra. Pikë.

Fatmir Xhafaj – Dakord!

Një koment të fundit ka zonja Benhard, meqenëse e kërkoi fjalën .

(Ndërhyrje në anglisht)

Agnes Bernhard – *(flet përkthyesi)* I vetmi dokument ku unë mund të mbështetem, janë dokumentet kushtetuese. Po të lexojmë ligjin 147, paragrafin 3, thotë që legjislatori i jep të drejtë që të krijohen procedura me ligj për procesin e përzgjedhjes.

I dëgjova me vëmendje të gjitha diskutimet që u bënë dhe dua të përmend versionin e parë të ndryshimeve kushtetuese, pastaj, sipas historikut, versioni i dytë i ndryshimeve kushtetuese. Këtu dëgjova që janë fshirë pjesë nga versioni i parë në krahasim me versionin e dytë, por do të thosha se edhe këto pjesë që mund të ndryshonin, nuk do të thonë se hiqet e drejta që këto procedura shtesë të rregullohen me ligj.

Të gjitha këto ndryshime, si versioni i parë edhe i dytë, nuk përjashtojnë mundësinë që këto procedura shtesë të nominimit të rregullohen me ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Oerd Bylykbashi – Shumica prej nesh kanë eksperiencë të mjaftueshme për të qenë të ulur tek ajo tryeza aty. Me gjithë respektin reciprok, të mos themi çudira. Flas për praktikën tonë këtu, por jam i bindur që edhe në vende të tjera është kështu.

Të sqarosh më mirë procedurën, ta bësh të funksionojë, po, ta autorizon Kushtetuta që ta bësh me ligj. Kur Kushtetuta nuk parashikon gjë, por kërkon produktin, si, për shembull “procedurën ma përcakto me ligj”, është fushë e hapur brenda parimeve që ta rregullosh. Të shtosh procedura, organe dhe kritere që Kushtetuta nuk i parashikon dhe që për me tepër se kaq, transformojnë, deformojnë procesin dhe të drejtat e organeve kushtetuese, ia marrin dhe ia çojnë dikujt tjetër që nuk është as organ kushtetues, më keq, madje as i përmendur në Kushtetutë. Besoj se zoti Ibrahimimi e ka parasysh cilës gjë i referohem. “Organ kushtetues, organ i përcaktuar nga Kushtetuta, organ i përmendur nga Kushtetuta”. Janë tre kategori, të cilat nuk i kam ndarë unë, por i ka ndarë Gjykata Kushtetuese shqiptare. Ia marrim dhe ia çojmë një organi që e rregullon ligji, por që Kushtetuta nuk e ka. Të shkohet kaq larg, vetëm duke gjetur një fragment në një ligj, që në kushte normale të gjithë e kuptojmë ndryshe, qartazi tregon një objektiv kokëfortë. Sigurisht, objektivat politikë janë gjithmonë “kokëfortë”, por mos i qëndroni, sepse nuk i bën nder askujt në këtë histori ekspertize. Askush prej nesh nuk ka dalë sot nga bankat e shkollës, dhe nuk është sot për herë të parë në këtë eksperiencë profesionale.

Kurrë nuk kam dëgjuar, përfshirë edhe kolegët, me të cilët kam punuar, edhe si ekspert, ndonjëherë këtë lloj arsytimi. Duke qenë se nuk ka ekzistuar asnjëherë, do të thotë se ka një qëndrim të pastër për të arritur diku tjetër, që të mos jetë Kuvendi që do të zgjedhë midis kandidatave që do të vijnë, por të jetë përpara ky grupi që kapet politikisht që ta ndajë, dhe më pas Kuvendi t’i vërë vetëm vulën. Se, nëse nuk do të bjerë dakord midis 10 kandidatave, të majta, flakë të kuqe, apo blu e thellë, nuk ka rëndësi, kur t’i vijë radha përkatëse, shorti të përzgjedhë një nga 10 apo 5 kandidatave, por pa pasur mundësi Kuvendi për këtë përzgjedhje. Po shkoni shumë larg. Ato që kishim për të thënë, jua thamë. Qëndrimi juaj, unë e shoh që është stoik dhe nuk lëviz, por nuk keni tagrin për asnjë sekondë, nuk ju ka veshur askush me tagrin për të ndryshuar atë që është miratuar në Kushtetutë në datën 22 korrik, sepse kjo është shumë e rëndë. E kam thënë edhe herë tjetër, nëse ky është standardi i ekspertizës që do t’i vijë këtij parlamenti, të paktën në reformën zgjedhore, kjo nuk ka për të ndodhur.

Fatmir Xhafaj- Faleminderit!

Agnes Bernhard – *(flet përthyesi)* Do të doja të shtoja një argument. Po të shikojmë nenin 147, në paragrafin e tretë thuhet se anëtarët gjyqtarë në fillim fare ishte

përmendur që do të zgjidheshin nëpërmjet një procedure të hapur dhe transparente. Pastaj u ra dakord që ajo të zgjidhet nëpërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ne duam të ndjekim të njëjtën procedurë edhe për zgjedhjen e anëtarëve jogjyqtarë të këtij këshilli.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Një moment, sepse kur flitet për gjyqtarët, bëhet fjalë për qeverisjen e gjyqësorit, dhe nuk është e njëjtë me pjesën tjetër.

Fatmir Xhafaj – Pse nuk janë anëtarët e Lartë të Këshillit Gjyqësor? Të barasvlershëm janë?

Oerd Bylykbashi – Sepse është parimi i vetëkontrollit brenda.

Fatmir Xhafaj – I kujt? Janë të barabartë.

Oerd Bylykbashi – Jo, nuk janë të barabartë. Prandaj ajo pjesë zgjidhet në atë formë dhe Kushtetuta nuk e fut sekretaren e Përgjithshme të Kuvendit te zgjedhja e gjyqtarëve. Po të ishte ashtu, do të vinin të gjithë gjyqtarët te sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit. Pse nuk vjen pjesa e gjyqtarëve te sekretari i Përgjithshëm? Pikërisht sepse ka trajtim tjetër. Po këtu janë kapur kaq keq sa që nuk gjejnë as argumentet si të dalin nga kjo pikë!

Fatmir Xhafaj – Edhe një herë po e përsëris, neni 147, pika 3, gjysma e fjalisë është e qartë për anëtarët gjyqtarë, pjesa e dytë e fjalisë është për anëtarët jogjyqtarë dhe jep kriteret, dhe në fund thotë: “Kritere të tjera dhe procedura për përzgjedhjen e kandidatëve rregullohen me ligj”. E ka thënë qartë Kushtetuta dhe është shkruar e zeza në të bardhë.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, ka diçka që është shumë e thjeshtë për ne juristët. Ajo që ju thoni është te pika 3, besoj e kanë të qartë edhe ekspertët.

Fatmir Xhafaj – Për anëtarët jogjyqtarë.

Oerd Bylykbashi - Deri në këtë pikë, Kushtetuta ka parashikuar minimumin: “Këshilli i Lartë Gjyqësor përbëhet nga 11 anëtarë, prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarë, zgjidhen nga nivele të pushtetit gjyqësor dhe 5 anëtarë i përzgjedh Kuvendi nga radhët e juristëve gjyqtarë”. Pra, i ka ndarë në dy kategori. Kaq ka thënë deri në këtë pikë.

Pastaj vazhdon te pika sa do të jenë, nga do të zgjidhen këta anëtarë, nga vijnë dhe thotë: “Kriteret me ligj”. Sigurisht, nuk ka ardhur ende pika 4, që ka përcaktuar në mënyrë kushtetuese organet dhe procedurat që i mbeten pa sqaruar pas pikës 4 mund të

shtojë me ligj, por jo pse është thënë te pika 3, ndërkohë që është sqaruar te pika 4 në detaje, mund të shtojmë dhe të bëjmë ne. Sigurisht, mund të mendoni edhe procese që nuk na shkon mendja fare, mund të fillojë procesi edhe në Bruksel apo Londër, nuk ka problem, po përse e shtojmë me ligj ne këtë? Jemi komplet jashtë piste. Pika 3 nuk mund ta superojë atë që është përcaktuar në pikën 4. Organe, procedura dhe rezultat në fund fare.

Fatmir Xhafaj – E qartë. E mbyllim këtë diskutim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E mora vesh që jeni kundër.

Gent Strazimiri – Kam përshtypjen se është një keqkuptim që mund të zgjidhet lehtë fare. E kam me ekspertin, jeni duke thënë se mbledhja e përgjithshme e avokatisë dhe mbledhja e përgjithshme e Këshillit Pedagogjik është procedurë dhe jo organ që shtohet?

(Mungesë audio)

Faleminderit! E mora përgjigjen.

(Mungesë audio)

Fatmir Xhafaj- Atëherë vazhdojmë votimin për nenin 3, për të cilin u bë gjithë ky debat.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, ka një amendament të propozuar nga ne për të ndryshuar dhe riformuluar nenin 3, paragrafët 3, 4 dhe 5. Sipas formulimit, do ta lexoj meqë është i shkurtër. Amendamenti numër 1 në materialin e paraqitur në komision, ku sipas propozimit tonë, paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 3 riformulohen në paragrafin 3 me këtë përmbajtje: “ Anëtarët jo gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor zgjidhen nga Kuvendi mbi bazën e kandidimit të lirë, transparent dhe publik që synon përzgjedhjen e kandidatëve me integritetin më të lartë profesional dhe moral, duke respektuar raportin: 2 anëtarë nga radhët e avokatëve, 2 anëtarë nga radhët e pedagogëve dhe një anëtar nga shoqëria civile”.

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord me këtë amendament? Kundër? Abstenime?

Rrëzohet!

Oerd Bylykbashi – Si rrëzohet? Kush është kundër?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Bie amendamenti!

Oerd Bylykbashi – Hidhe në votim nenin 3.

Fatmir Xhafaj – Neni 3. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, detyrohem të bëj një shpjegim të votës. Mbas një debati të gjatë, gjithsesi besoj i vlefshëm, u bë shumë e qartë se komisioni me instrumentet e tij, edhe antikushtetues të vendimmarrjes, nuk bëri gjë tjetër veçse rrëzoi dispozitën kushtetuese të miratuar me konsensus. Është një shkelje haptazi, flagrante e gërmës, jo vetëm e frymës që amendamenti kushtetues i 22 korrikut solli për nenin 147 të Kushtetutës. Është një votim i qëllimshëm, i hapur, me vetëdije të plotë edhe në keqbesim, sepse gjithë këto orë debat e pozicionojnë shumë qartë qëndrimin tuaj që marrëveshjen e 21 korrikut nuk e kishit për gjë tjetër veçse për të kaluar radhën dhe për ta bërë përsëri ashtu siç doni.

Zoti kryetar, po ju kujtoj se ju keni bërë një deklaratë në datën 22 korrik publikisht në media, ku keni thënë se, pavarësisht se është miratuar në këtë formë, përsëri do të shkonte në këtë version. Pra, qëllimi politik, ashtu siç na u tha edhe nga ekspertët, objektivi politik, strategjik i reformës u realizua nëpërmjet kësaj thyerje të konsensusit politik dhe më keq akoma, të nenit kushtetues.

Nëse marrëveshja konsensuale e 21 korrikut bie për një çështje kaq të rëndësishme, ashtu siç ka rënë edhe për çështje të tjera, por kjo është një nga çështjet më të debatuar dhe më të rëndësishme për të cilën u arrit marrëveshje politike me ndërhyrje ndërkombëtare, edhe pse zoti Majko nuk është i bindur, sepse nuk është se i pëlqejnë shumë ndërkombëtarët, kjo është shenjë që në këtë histori, në këtë ligj kaq të rëndësishëm për të miratuar një sistem, i cili do të qeverisë nesër sistemin e drejtësisë kur ju jeni gati ta thyeni Kushtetutën dhe konsensusin këtu, sigurisht që do të vazhdoni në të njëjtën formë.

Kjo është prova më e madhe sot, që me këtë keni ndër mend të zhbëni çdo lloj konsensusi politik në këtë proces dhe për rrjedhojë është fare e kotë që vazhdojmë e diskutojmë këtu në këtë formë. Mund t'i vendosni çdo lloj GENL-je sipër si vulë, por nuk është se e certifikon në përputhje me Kushtetutën këtë që po miratohet sot.

Pra, edhe një herë shpjegoj se vota jonë është kundër, sepse ky votim që ju sapo bëtë është në kundërshtim me Kushtetutën, është tregues i qartë se nuk keni ndër mend të respektoni konsensusin dhe, për rrjedhojë, keni zhbërë edhe gjysmën e këtij komisioni që është opozita. Nuk ju duhemi dhe është e kotë që vazhdojmë diskutimin.

(Mungesë audio).

Fatmir Xhafaj – Ky ishte një debat normal siç bëhet përherë në çdo strukturë parlamentare, në komisione apo në seancë parlamentare. Opozita do të duhet të kuptojë se jo çdo gjë që thotë ajo ka vlerën e së vërtetës, jo çdo gjë që thotë ajo është e vetmja vlerë kushtetuese, jo çdo gjë që thotë ajo është monopoli i dijes dhe i argumentit.

Askush nuk ka ndërmend t'i shmanget gjykimit dhe vlerësimit kushtetues, si dhe mosrespektimit të Kushtetutës, përkundrazi, mënyra sesi po detajohet ligji, është thjesht dhe vetëm respektimi i Kushtetutës, i rregullimit të saj, i kompromisit kushtetues nëse doni ta quajmë kështu, në germë dhe në frymë.

Gjithsesi, largimi i opozitës është në çmimin e saj. Nuk është hera e parë. Për fat të keq të procesit, opozita është larguar shpeshherë nga kjo sallë, aq shpesh sa që më shumë ka qenë jashtë sesa brenda kësaj sale, dhe për më keq, edhe kur ka qenë brenda, ka dashur të imponohet me vendimmarrjet e veta, gjë që përsëritet dhe kjo është absurde. Kompromisi kushtetues i ka dhënë një rol të jashtëzakonshëm opozitës në proces dhe sikur vetëm atë rol të ushtrojë, është përtej numrave që ka opozita dhe përtej numrave që do të ketë nesër çdo lloj opozite në funksion për të pasur një rol më aktiv. Në qoftë se opozita kërkon ta ndërtojë ligjin sipas shijes dhe interesave të veta, kjo pastaj është një çështje që ndahemi thellësisht.

Gjithsesi, neni 3 u miratua me ndryshime.

Vazhdojmë me nenin 4 “Statusi i anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Po, fjala për ju, vetëm shkurt.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, kam bërë dy saktësime bazuar në sugjerimet tona. Është riformuluar paragrafi i tretë i këtij neni ku thuhet: “Për efekt të vlerësimit të veprimtarisë së anëtarëve gjyqtarë, sipas kuptimit të ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, veprimtaria e tyre si anëtarë të konsiderohet e vlerësuar në vlerësimin e pikëve profesionale “shumë mirë”, përveç rasteve ku ndaj anëtarit të Këshillit vendoset një masë disiplinore”.

Gjithashtu, kemi pasur një diskutim lidhur me shprehjen latine “*mutandis mutandis*”, e cila ka krijuar keqkuptime edhe në rekomandimin e kolegëve të opozitës, që kanë kërkuar të rregullohet.

Bëj një propozim, nëse do të biem dakord, të shtojmë një nen ku të kemi disa përkufizime. Kjo e zgjidh shumë mirë problemin, e përdorim termin latin ashtu siç është, që të mos krijojë keqkuptime dhe shpjegimin e tij e vendosim te neni i përkufizimeve.

Gjithashtu, është riformuluar edhe pika 4, besoj e mbani mend, për konfliktin e interesit, ku kemi thënë: “Anëtari gjyqtar i këshillit nuk mund të transferohet, ngrihet në detyrë apo të delegohet gjatë tre vjetëve, pas përfundimit të mandatit”. Pra, jo vetëm gjatë kohës që është në detyrë, por edhe gjatë tre vjetëve pas përfundimit të mandatit.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Zoti Ibrahim, fjala për ju.

Gent Ibrahim - Shumë dakord, madje në dokumentin tonë të punës kemi ecur përpara me reflektimin e këtyre.

Fatmir Xhafaj – Dakord neni 4 me ndryshimet.

Miratohet!

Neni 5 “Shkeljet disiplinore të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Vasilika Hysi – Nuk ka problem, përveçse shqipërimin që i është bërë shprehjes “*mutandis mutandis*”.

Fatmir Xhafaj – Po, dakord. “Për aq sa është e mundur”, kjo është logjika, përkthimi në shqip i kësaj shprehje, besoj.

Miratohet neni 5 me ndryshimet.

Neni 6 “Procedura disiplinore”.

Vasilika Hysi – Në nenin 6 është bërë një riformulim i paragrafit të tretë lidhur me kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për pezullimin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor duke iu referuar rregullimeve që parashikon ligji 76 mbi ndryshimet që iu bënë Kushtetutës.

Gjithashtu, në paragrafin 4, bazuar edhe në sugjerimet që ne kemi bërë, për të sqaruar sesi ligji do të gjykojë procedurat disiplinore ndaj anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ekspertët kanë bërë plotësimet përkatëse.

Fatmir Xhafaj – A keni mundësi që ta evitohet këtë te neni 26, pika 3? Sipas parashikimit të bërë në ligj, “Gjykata Kushtetuese vendos pezullimin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në rastet e parashikuara në Kushtetutë”, pra sipas parashikimit kushtetues. Sepse kështu...

Jeni dakord me ndryshimet?

Miratohet!

Ndryshime teknike janë, kështu që shiheni këtë që të mos ketë shumë ngarkesë fjalia.

Neni 7.

Vasilika Hysi – Në nenin 7 sugjeroj të shtohen dy kritere që duhet t'i përmbushin gjyqtarët që do të zgjidhen në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, bazuar në ligjin “Për pastërtinë e figurave”, në ligjin që kemi thënë për bashkëpunëtorët e shërbimeve, pra të shtohet germa “dh” “Të mos ketë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë, ose të favorizuar në Shërbimet e Inteligjencës para vitit 1990”, dhe germa “e”. “Të mos jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i Shërbimeve të Inteligjencës, sot”.

Kjo është ideja.

Fatmir Xhafaj – Po, edhe kjo “Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të të gjitha niveleve” duhet thënë në fjalinë e parë.

Neni 7, dakord me ndryshimet?

Miratohet!

Neni 8 “Mbështetja e kandidatëve”.

Vasilika Hysi – Nuk ka problem.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 8?

Miratohet!

Neni 9 “Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit”.

Vasilika Hysi – Meqenëse flasim për anëtarë dhe gjyqtarë, mendoj se duhet të saktësohet, ndaj në paragrafin e parë duhet të themi që “jo më vonë se 4 muaj nga data e mbarimit të mandatit të anëtarëve gjyqtarë”, gjithashtu edhe te paragrafi 3 “dorëzohet shprehja e interesit”, thuhet.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 9 me këto ndryshime?

Miratohet!

Neni 10 “Paraqitja dhe shqyrtimi i shprehjes së interesit”.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, kemi bërë një sugjerim që të shtojmë një formular të vetëdeklarimit të rekordeve penale sipas legjislacionit për pastërtinë e figurave. Ne kemi miratuar një ligj që është ligji 138 dhe është normale. Mendojmë që riformulimi të bëhet sipas ligjit “Për pastërtinë e figurave”. E kemi quajtur shkurt ligjet e...

Fatmir Xhafaj – Pra, te formularët e vetëdeklarimit të rekordeve penale sipas ligjit “Për dekriminalizimin”, është ok?

Vasilika Hysi – Jo ligjin “Për dekriminalizimin”, sepse do të themi ligjin “Për pastërtinë e figurave”.

Fatmir Xhafaj – Jo, për integritetin!

Vasilika Hysi – Po integritetin... kjo është saktësim.

Fatmir Xhafaj – Dakord me këtë ndryshim te neni 10?

Miratohet!

Neni 11.

Vasilika Hysi – Në nenin 11 ka disa redaktime, por njëkohësisht në paragrafin e dytë është shtuar një fjali ku thuhet “Shorti për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Kualifikimit organizohet nën përgjegjësinë e kryetarit të Gjykatës së Lartë”, pra fjala “kujdes” që ka qenë, është zëvendësuar me fjalën “përgjegjësi” në të gjithë nenin.

Gjithashtu, është riformuluar në bazë të sugjerimeve që unë kam bërë në mbledhje, paragrafi 5, ku bëhet fjalë për thirrjen e dytë në qoftë se nuk paraqitet asnjë kandidat nga shkallët e përfaqësuara nga gjyqësori, zgjedhja do të bëhet me short nga radhët e gjyqtarëve të nivelit të pa përfaqësuar dhe kjo është e nevojshme për të respektuar parimin kushtetues që duhet të ketë përfaqësi nga të tri nivelet.

Është kërkesë që e përcakton neni 147.

Fatmir Xhafaj – Zoti Ibrahim, si ta kuptoj? Ideja është që në qoftë se nuk ka kandidatë nga Gjykata e Lartë, do të hidhet me short? Ky është kuptimi, apo jo?

Gent Ibrahim - Ai është kuptimi, por duke qenë se edhe EURALIUS edhe opozita kanë një dyshim për këtë zgjidhje, sepse ju duket pak a shumë se bie ndesh me patundshmërinë e magjistratit, ndoshta mund ta diskutojmë pasi të dëgjojmë propozimin e zonjës Bernhard.

Agnes Bernhard – *(flet përthyesi)* Ne shikojmë një procedurë pak ndryshe. Nuk e kërkojmë që të bëhet me short, sepse kjo procedurë do të shkelte të drejtat e njeriut, ndaj edhe ne parashikojmë diçka tjetër. Përzgjedhja e këtyre kandidatëve do të bëhet nga lista e atyre kandidatëve që kanë pranuar të kandidojnë për këtë pozicion. Çdo kandidat nga këta që plotëson kushtet ligjore për t'u bërë anëtar i Këshillit dhe kushtet e tjera profesionale, do të përzgjidhet nga radha e këtyre, dhe ata kandidatë që pranojnë të ngrihen në pozicionin dhe në nivelin e atyre kandidatëve që janë të ligjshëm për t'u zgjedhur në këtë këshill, atëherë përzgjedhja do të bëhet nga radhët e këtyre kandidatëve.

Fatmir Xhafaj – Kjo ishte e parashtruar edhe në materialin e opozitës, kam përshtypjen?

Gent Ibrahimi - Po, është e parashikuar në materialin e opozitës. Në fakt, është edhe një version më i hershëm që kishim ne, kështu që në dritën e këtyre propozimeve të reja, unë besoj që mund të marrim propozimin e formuluar nga zonja Bernhard.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Jam dakord me propozimin e sjellë nga zonja Agnes, njëkohësisht, zoti kryetar, në komision ne kemi bërë një vërejtje dhe një sugjerim që afatet për të paraqitur shprehjen e interesit janë të ngushta në ligj dhe krijojnë një diskriminim midis atyre që kandidonin për herë të parë dhe të dytëve, dhe kemi kërkuar që në thirrjen e dytë, shprehja e interesit të bëhet brenda 15 ditëve dhe jo 7 ditë nga dita e shpalljes së thirrjes së dytë. Kjo do t'i vinte kandidatët në pozitë të barabartë dhe u jepte kohën e mjaftueshme për të plotësuar gjithë dokumentacionin.

Fatmir Xhafaj – Dakord, zonja Agnes dhe zoti Ibrahimi?

Dakord, faleminderit!

Miratohet neni 11 me ndryshimet e propozuara nga relatorja dhe nga ekspertët e komisionit.

Neni 12 “Ankimet kundër vendimeve të përjashtimit”.

Vasilika Hysi – Kam një sugjerim që e kam theksuar edhe kur kemi diskutuar që afati i përgatitjes së ankimit të mos jetë 3 ditë, por të jetë 5 ditë edhe për një arsye të thjeshtë që ne nuk i kemi përcaktuar ditë pune apo ditë kalendarike. Në këtë kuadër, do të ishte e mjaftueshme për të bërë ankimin dhe për të pasur gjithë dokumentet e nevojshme për t'ia paraqitur Gjykatës së Apelit.

Fatmir Xhafaj – Kam edhe unë diçka. Te ligji i prokurorisë, kur i kemi dhënë mundësinë apelit që të shqyrtojë ankimet e kandidatëve, kemi vendosur një përkufizim/detyrim që apeli nuk mund t'i hyjë vlerësimit në meritë, por do të shikojë thjesht procedurën, sepse, nëse apeli do të hynte këtu dhe më pas do t'i hyjë vlerësimit në meritë, gjykimit në meritë, gjykimit substancial të procesit, atëherë do të kishim një proces me shumë të panjohura. Okej?

Gent Ibrahimi - Në fakt, në disa formulime më poshtë edhe ne e kemi, por nuk e di pse mungon këtu.

Fatmir Xhafaj – Gjithsesi, ai duhet parë, sepse është një formulim për të ruajtur të njëjtin standard. Dakord?

Miratohet neni 12 me këto ndryshime, ndoshta edhe me nevojën për të shtuar një pikë të tretë nëse nuk do të shihet më pas për çështjen “çfarë gjykon apeli”. Faleminderit!

Neni 13 “Thirrja e mbledhjes së përgjithshme për zgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Ka diçka për të shtuar lidhur me këtë nen?

Vasilika Hysi – Në këtë nen ka disa saktësime, sikurse me të drejtë ju thatë, zoti kryetar, të termit “shkallë të niveleve” dhe plotësimit të terminologjisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njëkohësisht te pika 4, aty ku thuhet se “kjo është pika e vetme” mund të themi “përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, zgjedhja e anëtarit të Këshillit është pika e vetme në rendin e ditës së mbledhjes së përgjithshme”.

Fatmir Xhafaj – Dakord? Faleminderit!

Miratohet!

Neni 14 “Kuorumi”.

Vasilika Hysi – Është në rregull.

Fatmir Xhafaj – Okej. Faleminderit!

Miratohet!

Neni 15 “Thirrja”.

Vasilika Hysi – Po, është sugjeruar meqenëse nuk ka afat se kur thirret, të thuhet “të thirret menjëherë”, pra në rast se këtë “mbledhja e përgjithshme nuk thirret”, të mund ta thërrasë menjëherë 1/10 e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve.

Pjesa tjetër pastaj është korrekte.

Fatmir Xhafaj – Por edhe kjo me paraqitjen e kërkesës së kancelarit duhet specifikuar në zbardhje.

Dakord me nenin 15?

Miratohet!

Neni 16 “Procesi i votimit për zgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Vasilika Hysi – Këtu ka disa saktësime, të cilat janë bërë në disa paragrafë. Kemi pasur parasysh edhe sugjerimet e kolegut Vasili, por njëkohësisht edhe nevojën për të pasur një përcaktim të saktë të kompetencave për anëtarët e komisionit që do të merren me procesin e votimit.

Njëkohësisht, është riformuluar edhe paragrafi 7. Nuk e di nëse do të duhet ta lexojmë me saktësi, pra ndryshimi është në paragrafin 3 ku thuhet: “Procesi i votimit është i hapur për mediat dhe gjithë vëzhguesit e tjerë që shprehin interesin për të ndjekur procesin. Vëzhguesit autorizohen paraprakisht nga kryetari i Gjykatës së Lartë. Kryetari i Kuvendit, Ministri i Drejtësisë ose përfaqësuesit e tyre mund të marrin pjesë si vëzhgues në mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor pa autorizim paraprak të kryetarit të Gjykatës së Lartë”.

Gjithashtu, në paragrafin 4...

Fatmir Xhafaj – Më falni, a mundet që krahas ministrit të Drejtësisë, këtu t’i japim mundësi Komisionit të Ligjeve të nominojë dy përfaqësues, ku njëri detyrimisht të jetë nga opozita? Mund të mos jetë as kryetari i komisionit dhe as nënkryetari, këtë le ta caktojnë të dy krahët, sepse Kryetari i Kuvendit, ministri i Drejtësisë dhe opozita nuk është e përfaqësuar. A mund ta hedhim këtë dhe më pas e replikojmë në të gjitha që të kenë mundësi, opozita të vëzhgojë gjithë këtë proces, gjithë konkurrimin te avokatët etj? Biem dakord? Meqenëse procesi në finale do të vejë në komision pastaj, të dyja krahët të kenë një njeri përfaqësues dhe, nëse duan të venë ose jo, zgjedhja është e tyre.

Biem dakord, kuptohet siç e keni lënë, sepse edhe Kryetari i Kuvendit, si edhe ministri i Drejtësisë mund të shkojnë vet ose të caktojnë përfaqësues, edhe komisioni cakton dy përfaqësues, një nga maxhoranca dhe një nga opozita.

Gent Ibrahim - Shumë dakord! Duke pasur parasysh edhe shqetësimet që janë ngritur këtu për cilësinë e procesit zgjedhor brenda grupeve...

Fatmir Xhafaj – Le të ketë monitorim në fund të fundit.

Po, faleminderit!

Vasilika Hysi – Gjithashtu, zoti kryetar, ka një riformulim të pikës 4, është thjesht për qartësim për të kuptuar përgjegjësinë që ka edhe kryetari i Gjykatës së Lartë në këtë proces.

Pra, fjalia aktuale ndahet në dy pjesë, ku thuhet: “Për administrimin e procesit të votimit krijohet komisioni i votimit, i përbërë nga tre ndihmësmagjistratë të Gjykatës së Lartë të zgjedhur me short. Shorti për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit të votimit organizohet nën përgjegjësinë e kryetarit të Gjykatës së Lartë”.

Paragrafi i shtatë ka një saktësim, ku thuhet “me propozim të kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe në përputhje me përcaktimet e këtij ligji” shtohet togfjalëshi “mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve (shtohet fjala “e përgjithshme”) mund të miratojë rregulla më të hollësishme për procesin e votimit, zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të votimit”. Shqetësim që unë ngrita është që mbledhja e përgjithshme nuk mund të krijojë rregulla ekstra, por çdo rregull do të jetë detajim i rregullave të përcaktuara në këtë ligj. Ky është formulimi i saktë.

Fatmir Xhafaj – A jeni dakord me ndryshimet e bëra te pikat, 2, 3, 4, 5 dhe 7? Dakord.

Faleminderit!

Neni 17 “Numërimi i votave dhe shpallja e rezultatit”.

Vasilika Hysi – Janë bërë thjesht disa saktësime. Në paragrafin e parë fjala “nën kujdesin” bëhet “nën përgjegjësinë”. Janë thjesht redaktime të teknikës legjislative.

Edhe të paragrafi 2, germa “d” duhet të thuhet “për cilin kandidat është votuar” dhe jo “kë ka votuar”.

Te paragrafi 4 folja “përpilohet” zëvendësohet me foljen “hartojmë”. Njëkohësisht, kemi thënë që miratohet një procesverbal, i cili tregon numrin e pjesëmarrësve në votim. Janë redaktime të teknikës legjislative dhe janë të nevojshme.

Njëkohësisht, ka një ndryshim te paragrafët 6 dhe 7, ku thuhet: “Procesverbalet origjinale, që tregojnë numrin e pjesëmarrësve në mbledhjen e përgjithshme, rezultati i numërimit të votave, i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit, i dërgohet menjëherë Gjykatës së Lartë.

Te paragrafi 7 ka një saktësim më tepër të teknikës, ku thuhet: “Vendimet me rezultatin e zgjedhjeve, shpalljen e fituesve, çdo vendim i ndërmjetëm dhe procesverbalet nënshkruhen bashkërisht nga anëtarët e komisionit. Vendimet njoftohen publikisht në fund të mbledhjes së përgjithshme dhe shpallen zyrtarisht në faqen zyrtare.”

Fatmir Xhafaj – Jemi dakord me këto ndryshime që nuk prekin thelbin, por janë të natyrës redaktoriale të teknikës legislative.

Neni 18 “Ankimet kundër vendimeve të mbledhjes së përgjithshme”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju keni vendosur shtesën: “Gjykata mund të vendosë përsëritjen e zgjedhjeve vetëm në qoftë se shkeljet procedurale të parashikuara në pikën 1 të këtij neni...”

Agnes Bernhard – *(flet përkthyesi)* Ne, në fakt, ndërhymë duke dashur ta kufizojmë mënyrën ose hapësirën e kërimit të apelit vetëm nëse janë bërë shkelje në procedura, të cilat ndikojnë në rezultatin e votimit. Vetëm për këtë të bëhet apeli.

Fatmir Xhafaj – Shprehja e saktë, me sa shoh unë, është: “Gjykata mund të vendosë përsëritjen e zgjedhjeve vetëm në qoftë se shkeljet procedurale të parashikuara në pikën 1 të këtij neni vërtetohen dhe janë të tilla që kanë ndikuar ose mund të kishin ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve. Vendimi i gjykatës është përfundimtar dhe i formës së prerë”.

Agnes Bernhard – *(flet përkthyesi)* Procedurat që kanë ose që mund të kenë efekt mbi rezultatin e votimit.

Fatmir Xhafaj – Ndërhyrjet te pikat 1 dhe 3 janë redaktoriale.

A jeni dakord me nenin 18 me ndryshimet dhe shtesën e paraqitur? Dakord.

Neni 19.

Vasilika Hysi – Te neni 19, zoti kryetar, unë sot paradite kam parë me vëmendje sugjerimin e opozitës, bazuar në nenin 147, paragrafi 3 i Kushtetutës, ligjvënësi ka të drejtë të përcaktojë disa kriterë shtesë, nëse dëshiron, që duhet t’i plotësojnë kandidatët. Në fakt, në këtë nen, ka disa kriterë të përcaktuara, por ia vlen që ndonjë kriter, i cili është parashtruar nga kolegët e opozitës, të merret në konsideratë.

Në radhë të parë, sugjerojmë që në germën “c” të paragrafit 2, afati që një person të ketë ushtruar profesionin e avokatit duhet të jetë 15 vjet. Ky është një sugjerim i

ardhur edhe nga zoti Vasili, por përputhet edhe me ato kriteret që ka Kushtetuta, që anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor duhet të kenë të paktën 15 vjet në profesion.

E dyta, në germën “ç”, që është parashikuar në këtë nen të ligjit, thuhet : “Personi në kohën e kandidimit nuk duhet të jetë kryetar i një dhome avokatie ose anëtar i organeve drejtuese të grupeve të interesit, të tilla si shoqata avokatësh, sindikatash dhe avokatë e të tjerë”. Në këtë mënyrë, shmanget konflikti i interesit që përfaqësuesit...

Fatmir Xhafaj – Anëtarë të këshillit të përgjithshëm janë të gjithë ata, të vëmë të paktën “drejtuesit e tyre”.

Vasilika Hysi – Kemi thënë vetëm kryetarët.

Fatmir Xhafaj – E keni vënë “anëtarët e organeve”, duhet “kryetarët e organeve drejtuese”.

Vasilika Hysi – Kjo mund të diskutohet.

Gent Ibrahim – Për dhomat përjashtohet vetëm kryetari, ndërsa për shoqatat dhe sindikatat përjashtohet krejt përbërja e organeve drejtuese që mund të jetë këshilli drejtues. Domethënë, ka një dallim. Ose kam frikë se sugjerohet kështu, se ka edhe dhoma të vogla, sepse të përjashtosh të gjithë organin drejtues të dhomës, mund të jetë gjysma e dhomës. Kështu që në rastin e dhomës ne mbajmë vetëm kryetarin...

Fatmir Xhafaj – Në një qytet apo në një rreth ata kaq janë. Kështu që duhet ta riformulojmë këtë bashkë me vërejtjen që ka bërë edhe zoti Vasili për ta bërë 15 vjet. Jemi dakord. Duhet të shtoni edhe këto “mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor”, sepse bien në kundërshtim me kriteret e mëparshme. A jeni dakord?

Vasilika Hysi – Ky është një kriter për të gjitha pozicionet. Njëkohësisht, zoti kryetar, opozita ka pasur një propozim, që kërkon se anëtari gjyqtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor të zgjidhet ai që është vetëm shtetas shqiptar, pra nuk pranohet që një person të ketë dyshtetësi. Personalisht, unë them që ky është diskriminim.

Fatmir Xhafaj – Më fal, por ne radhim e kaluar u thamë atyre që të mos ketë dyshtetësi, te SPAK-u.

Vasilika Hysi – Jo, kemi thënë vetëm për kryetarin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, por nuk kemi thënë për pozicionet e tjera. Pra, vetëm te drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, për shkak të natyrës që ka, të sekreteve që ka, të aksesit që ka nëpër dosjet e shërbimeve të inteligjencës kemi thënë që duhet të ketë vetëm shtetësi

shqiptare, ndërsa Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka të dhëna kaq sensitive në dosjet e shërbimeve të inteligjencës apo në fold-erë, të cilat mund të cenojnë atë që ne quajmë sekret shtetëror etj. Kjo është një pikë që në mund ta diskutojmë, meqenëse është një propozim i ardhur nga kolegët e opozitës.

Gent Ibrahim – Meraku i vetëm që kemi pasur këtu është se, duke qenë se këta dolën nga radari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, nuk ka mënyrë tjetër për të imponuar disa kushte më të larta. Dakord mund të thuhet “të ketë njohuri”. Mund ta zbutim pak.

Fatmir Xhafaj – Pra, ndryshimet janë: te germa “c” nga 10 në 15, germa “ç” të riformulohet, ajo e gjuhës së huaj, për të futur tre paragrafë për bashkëpunëtorët, për informatorët para ‘90-ës dhe ata aktualë, e treta dekriminalizimi, pika e katërt për të mos pasur jo më shumë se 1 kandidat, jo më shumë se 2 kandidatë, pra të futim fjalët “jo më shumë”.

Po, zonja Bernhard.

Agnes Bernhard –(flet përkthyesi) Do të doja që pikën e parë, numrin e kandidatëve, ta lija pak të hapur, duke pasur parasysh edhe diskutimet që bëri sot opozita në lidhje me numrin e personave të përzgjedhur që, ndoshta, është diçka që mund ta diskutojmë.

Fatmir Xhafaj – Dakord, e lëmë të hapur që të shohim sesi mund ta formulojmë më mirë këtë. Reflektojmë bashkë me relatoren qw të shohim ç’ mund të bëjmë.

Vasilika Hysi – Kolegët e opozitës, pavarësisht se nuk janë, ne i respektojmë, kanë kërkuar që kandidatët të bëjnë transparencë të potë të dokumenteve të gjithë të ardhurave të tyre në momentin kur bëjnë deklaratën e pasurisë. Njëkohësisht, kanë kërkuar të bëhet edhe në deklaratë e kontrollit të pastërtisë së figurave, pra të plotësojnë një formular. Kanë kërkuar dy gjëra: çdo kandidat që vjen të ketë edhe këto dy kritere shtesë.

Fatmir Xhafaj – A është e pranueshme për ju? Dakord. Faleminderit!

Neni 19 miratohet bashkë më ndryshimet.

Neni 20 “Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit”.

Vasilika Hysi – Në qoftë se ju kujtohet, ky nen ishte lënë i hapur dhe tashmë reflekton ndryshimet kushtetuese, konkretisht ndryshimi që është bërë te paragrafi 5 i nenit 147.

Ulsi Manja – Te paragrafi i parë i nenit 20 fjalët “jo më vonë se 4 muaj nga dita e mbarimit të mandatit”, duhet të bëhen “4 muaj përpara mbarimit të mandatit dhe jo më vonë nga dita e mbarimit...”.

Fatmir Xhafaj – Edhe te paragrafët e tjerë është e njëjta shprehje: duhet thënë përpara, se duket sikur nga dita që ka mbaruar më mbrapa. Pra, 4 muaj më parë sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit shpall vendet vakante në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme. Jemi dakord. Ka të drejtë zoti Manja.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, lidhur me njoftimin e anëtarëve të Dhomës së Avokatisë në adresën elektronike, mund të këtë problem me adresat elektronike. Duhet të shtonim edhe fjalët “në adresën elektronike të deklaruar”, sepse ai mund ta mbyllë një adresë dhe do të thotë më pas se nuk është njoftuar dhe mund ta çojë çështjen...

Fatmir Xhafaj – A biem dakord me riformulimin e nenit 20 sipas sugjerimeve që u bënë? Dakord.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon.)

Neni 21.

Vasilika Hysi – Te neni 21 kemi vetëm një saktësim “kandidati do të bashkëngjisë edhe formularin e vetëdeklarimit në kuadër të ligjit të pastërtisë së figurave”, pra shtohet germa “c”.

Fatmir Xhafaj – Keni venë këtu, gjithashtu një herë “deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore, pastaj thoni “një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë penale”. Ju lutem, unifikojeni tekstin!

Gent Ibrahimi – Në fakt, ka një argument që i korrespondon rëndësisë së shkeljes. Në rastin e dytë të jesh agjent aktiv i shërbimit të huaj besoj është...

Fatmir Xhafaj – Kjo bëhet 15 ditë nga shpallja e thirrjes.

Jemi dakord me ndryshimet e nenit 21.

Neni 22 “Verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore”.

Vasilika Hysi Sugjeroj që kandidati i përjashtuar të njoftohet individualisht me shkrim dhe në mënyrë arsyetuar për shkaqet e përjashtimit.

Fatmir Xhafaj – Thuhet “verifikim i plotësimit të kushteve ligjore. Pra, “kandidatët që plotësojnë kushtet” duhet shtuar ky paragrafi aty. A jeni dakord me ndryshimet e nenit 22? Dakord.

Neni 23 “Ankimet kundër vendimeve...”.

Vasilika Hysi – Ka vetëm një ndryshim te pika 1, paragrafi 1: afati i ankimit nga 3 ditë bëhet 5 ditë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Faleminderit!

Neni 24 “Thirrja e mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm dhe përzgjedhja e kandidaturave nga Dhoma e Avokatisë”.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshim, është reflektuar, dhe nga “60 ditë” bëhet në “80 ditë”.

Fatmir Xhafaj – Ndryshimi te pika 1, bëhet 80 ditë.

Në rregull.

Vasilika Hysi – Kështu e ka edhe drafti përpara.

Fatmir Xhafaj – “Jo më vonë se 80 ditë nga dita e mbarimit, 80 ditë para ditës së mbarimit”, kijeni parasysh të gjithë këtë që të mos e përsërisim më.

Dakord, zoti Ibrahim? Në rregull.

Miratohet neni 24, me ndryshimin.

Neni 25.

Vasilika Hysi - Zoti kryetar, në nenin 25 shtohet një paragraf, ku thuhet: “Numri i pjesëmarrësve të mbledhjes së këshillit të përgjithshëm shënohet në një listë emërore, të nënshkruar nga të gjithë të pranishmit që marrin pjesë”.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Në rregull, me ndryshimin.

Neni 26 “Procesi i votimit”.

Vasilika Hysi – Në nenin 26 ka një shtesë në paragrafin 4, ku thuhet: “Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë ose përfaqësuesi i tij mund të marrë pjesë si vëzhgues në mbledhjen e këshillit të përgjithshëm të dhomës pa autorizimin paraprak”.

Fatmir Xhafaj – Mos e lexo të gjithën.

Vasilika Hysi – Më fal, por doja të bëja lidhjen

Fatmir Xhafaj – “Votimi është i fshehtë dhe vetjak”.

Miratohet me ndryshimet në pikat 1 dhe 4.

Neni 27 “Numërimi i votave dhe shpallja e rezultatit”.

Vasilika Hysi – Është thjesht një formulim i germës “d”, ku thuhet: “Nuk është e qartë se për cilin kandidat është votuar”, njëkohësisht te germa “dh” pjesa me të kuqe është pjesa që është shtuar. Është votuar për një person që nuk është regjistruar si kandidat.

Gjithashtu, në pikën 4 duhet të saktësohet një fjali: “Në përfundim të procesit të votimit dhe numërimit të votave, anëtarët e komisionit të votimit përpilojnë një procesverbal, i cili tregon numrit e pjesëmarrësve.

Fatmir Xhafaj – “Edhe vendimin njoftojmë publikisht në fund të mbledhjes”.

Vasilika Hysi – Këto janë në draftin që keni përpara. Në pikën 6 përsëri duhet “procesverbali origjinal të tregojë numrin e pjesëmarrësve”.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, pika 3 ka ndryshime, pika 4 saktëson numrin e pjesëmarrësve; pika 6 tregon numrin e pjesëmarrësve dhe numrin e votave; pika 7 njoftimin e vendimeve.

Vasilika Hysi – Në pikën 7 shtohet: “Vendimet me rezultatet e zgjedhjeve, shpalljen e fituesve dhe çdo vendim i ndërmjetëm dhe procesverbalet nënshkruhen bashkë me anëtarët e komisionit të votimit. Vendimet njoftohen publikisht në fund të mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës së Avokatisë”. Kjo është dhe pjesa e transparencës.

Fatmir Xhafaj – Miratohet neni 27 me ndryshimet.

Neni 28 “Ankimet kundër vendimit”.

Vasilika Hysi – Edhe këtu është bërë një ndryshim i afateve të anikimit, në paragrafin e parë nga “3 ditë” bëhet “5 ditë”, gjithashtu ka një sugjerim nga EURALIUS që në paragrafin e dytë të shtohet një fjali.

Fatmir Xhafaj – “Këshilli drejtues mund të vendos përsëritjen e zgjedhjeve vetëm në qoftë se shkelet proceduralet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni vërtetohen dhe janë të tilla që kanë ndikuar ose mund të kishin ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve”.

Në rregull.

Vasilika Hysi – Po.

Kjo është bazuar në sugjerimin që keni bërë ju, zoti kryetar, në mbledhjet e mëparshme.

Fatmir Xhafaj – Në rregull me nenin 28, me ndryshimet dhe shtesat.

Vasilika Hysi – Gjithashtu, në nenin 28 te paragrafi i tretë, ku thuhet: “Vendimi i këshillit drejtues”, duhet ta saktësojmë se për cilin vendim bëhet fjalë.

Fatmir Xhafaj – Po ajo është redaktoriale.

Dakord me nenin 28, me shtesat dhe ndryshimet.

Neni 29 “Thirrja e mbledhjes”.

Vasilika Hysi – Nuk ka gjë, thjesht ndonjë redaktim.

Fatmir Xhafaj - Neni 24 “Dhoma e Avokatisë”.

Në rregull.

Miratohet neni 29 me këto ndryshime të pikës 1.

Neni 30.

Vasilika Hysi – Në nenin 30 ekspertët kanë reflektuar shqetësimin tonë, kanë thënë jo “30 ditë”, por e kanë bërë “60 ditë” dhe kjo është e drejtë. Ndërkohë, pajtohemi me shqetësimin që ngritët ju për të rregulluar shprehjen që të mos krijoj keqkuptime. Në paragrafin 2 janë shtuar fjalët: “Nuk marrin pjesën në mbledhjen e këshillit dhe në votim”. Në paragrafin 3 përcaktohet se për kë këshill të përgjithshëm bëhet fjalë, bëhet fjalë për Këshillin e Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Fatmir Xhafaj - Dakord neni 30, me ndryshimet, që kryesisht janë saktësuese dhe redaktoriale.

Neni 31.

Vasilika Hysi – Në nenin 31, sikurse edhe për nenet tjerë që bëjnë fjalë për kuorumin, kemi shtuar një paragraf të tretë, ku thuhet: “Numri i pjesëmarrësve në mbledhjen e këshillit të përgjithshëm shënohet në një listë emërore, të nënshkruar nga të gjithë të pranishmit që marrin pjesë në votim” .

Fatmir Xhafaj - Dakord me nenin 31, me shtesën e bërë në pikën 3. Në rregull, faleminderit!

Neni 32 “Procesi i votimit.”

Vasilika Hysi – Në nenin 32 “Procesi i votimit”, është bërë një shtesë, ku është parashikuar: “Jo vetëm ministri i Drejtësisë, por edhe “sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ose përfaqësuesit e tyre, mund të marrin pjesë si vëzhgues”, pra është shtuar fjala “sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe pjesëmarrja e tyre është pa autorizim paraprak”.

Fatmir Xhafaj – Ndoshta nuk duhet të fusim sekretarin e Përgjithshëm, se është nëpunës civil.

Vasilika Hysi – Ndoshta është ajo që thatë ju me të drejtë, që Kryetari i Kuvendit mund të delegojë dikë tjetër.

Fatmir Xhafaj - Siç e kemi atje, e delegon ai dhe e dyta komisioni, siç e thamë tek të gjitha, që të ketë përfshirje opozita dhe të mos e përsërisim më në raste të ngjashme, por pesha, pa dyshim, i ngelet ministrit.

Miratohet neni 32 me ndryshimet.

Neni 33.

Vasilika Hysi – Neni 33 është si neni që kemi diskutuar pak më parë për numërimin e votave dhe shpalljen e rezultatit, pra janë thjesht redaktime të fjalëve.

Fatmir Xhafaj - Te pikat 3, 6 dhe 7.

Vasilika Hysi – “Procesverbali duhet të tregojë edhe numrin e pjesëmarrësve në votim”.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 33.

Neni 34.

Vasilika Hysi - Përsëri te nenin 34 është i njëjti ndryshim, që është rritur koha nga “3 ditë” në “5 ditë” për të bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, njëkohësisht EURALIUS ka shtuar atë riformulimin, që me të drejtë ka thënë: “Gjykata mund të vendos përsëritjen e zgjedhjeve vetëm në qoftë se shkeljet procedurale të parashikuara në pikën 1 të këtij neni vërtetohen dhe janë të tilla, që kanë ndikim ose mund të kishin ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve”.

Fatmir Xhafaj – Te dyshi replikohet, se është e njëjta, “procedurë ankimore”, e drejta e gjykatës, si dhe kushti për të cilën duhet të vendosë.

Te neni 34 shtohet paragrafi i dytë dhe korrigjohet nga “3 ditë” në “5 ditë” te paragrafi i parë. Paragrafi 3 bëhet saktësimi “nga dita e njoftimit të gjykatës”.

Miratohet neni 34 me ndryshimet dhe shtesat e bëra.

Neni 35 “Vendimmarrja nga Kuvendi”.

Vasilika Hysi – Këtu do të bëjmë një saktësim për të qenë në përputhje me Kushtetutën, paragrafi i dytë...

Fatmir Xhafaj - Më fal, te neni 34?

Vasilika Hysi – Jo, te neni 35.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni, zonja Agnese!

Agnes Bernhard – *(flet përkthyesi)* Te neni 147 i Kushtetutës parashikohet një afat për vendimin e sekretarit të Përgjithshëm dhe te neni 34 do të donim të shtonim që aplikimet nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë të shënohet afati përfundimtar i aplikimit dhe t’i dërgohet sekretarit të Përgjithshëm pas apelimit.

Fatmir Xhafaj – Dakord me saktësimin.

Faleminderit!

Miratohet edhe neni 34 me ndryshimet e bëra.

Neni 35 “Vendimmarrja nga Kuvendi”.

Vasilika Hysi – Te neni 35, zoti kryetar, në pikën 2 duhet t’i përmbahemi afatit kushtetues që përcaktohet në pikën 7 të nenit 147 të Kushtetutës, pra nuk do të themi “jo më vonë se dy ditë”, por “jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e listës”. Edhe Kushtetuta këtë term përmend “jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e listës”.

Problemi i terminologjisë që thotë “jo më vonë” është term kushtetues. Ndoshta nuk mund të tingëllojë mirë, por Kushtetuta këtë ka përmendur “jo më vonë se 3 ditë”, “jo më vonë se 10 ditë”.

Fatmir Xhafaj – Në rregull është këtu, termi është i saktë, sepse pasi paraqiten.

Vasilika Hysi – Në vend të “2 ditëve” do të vendosim “3 ditë”.

Gjithashtu, ky nen, edhe për transparencë për kolegët, ka qenë një nen, i cili ka ndryshuar në bazë të formulës së 21 korrikut, pra është riformuluar në përputhje me nenin 147 të Kushtetutës, të cilën ne e diskutuam gjerësisht sot. Ky është neni i riparë komplet. Në qoftë se ju kujtohet, ne e lamë të hapur dhe kemi thënë se do të reflektohet Kushtetuta.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Vasilika Hysi – Nga ana tjetër, zoti kryetar, unë në mbledhje kam ngritur një shqetësim se çfarë do të ndodhë nëse një nga mandatet e anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë mbaron para kohe, pra anëtari avokat jep dorëheqjen, vdes, është në këto kushte. Këtu është krijuar një paragraf i ri nga ekspertët, i cili me të drejtë e ka zgjidhur shqetësimin që unë kam ngritur. Pra: “Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga avokatia, Kuvendi zgjedh një anëtar të ri nga lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret profesionale, morale të verifikuara nga sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, sipas pikës 1 të këtij neni, sipas procedurës dhe afateve të parashikuara në pikën 5 të këtij neni, pasi verifikon gatishmërinë e tyre për të shërbyer në Këshillin e Lartë Gjyqësor me një mandat të pjesshëm”. Pra, bëhet fjalë për vakancat që mund të krijohen për arsye të ndryshme.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Agnes Bernhard – *(flet përkthyesi)* Në fakt, unë shikoj ca kontradikta me nenin 147 të Kushtetutës, prandaj dëshiroj që t’i rishikonim edhe një herë këto dispozita më qartë.

Në paragrafin e parë mund të fshinim fjalët “nga përfundimi i shqyrtimit të ankimit”. Gjithashtu, dua të shtoj se sekretari i Përgjithshëm duhet të fshijë nga lista ata kandidatë që nuk plotësojnë kushtet formale. Dua të shtoj që sekretari i Përgjithshëm duhet të shikojë edhe kriteret profesionale dhe morale të kandidatit, që plotësojnë kushtet formale në përputhje me nenin 151 po të këtij ligji, ku kemi kriteret morale dhe profesionale për renditjen e kandidatit për emërimet në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu, dua të shtoj se sekretari i Përgjithshëm duhet të hartonte një listë me 4 kandidatë që plotësojnë kushtet morale dhe profesionale, të nxjerra nga lista e atyre që plotësojnë kushtet formale dhe listën e anëtarëve të kandidatëve që nuk kualifikohen. Të dyja listat e anëtarëve të kualifikuar dhe të pakualifikuar duhet t’i dorëzohen Kuvendit nga sekretari i Përgjithshëm dhe të shfaqen në faqen zyrtare të Kuvendit jo më vonë se 10 ditë nga marrja e vendimit.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, saktësime janë, gjithsesi kur i shohim të shkruara janë më të qarta. E kuptojmë, por e lëmë të hapur për ta riparë.

Agnes Bernhard – *(flet përkthyesi)* Atëherë, ne do t’i paraqesim të shkruara në shqip të gjitha propozimet për të gjitha paragrafët.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, saktësojini me relatoren nesër para mbledhjes së orës 10:00.

Dakord në parim me propozimin që u bë, por edhe me ndryshimin e pikës 6 të paraqitur nga zonja Hysi.

Miratohet neni 35 me ndryshimet.

Këtu e mbyllim mbledhjen për sot.

Nesër do të takohemi në orën 10:00 në këtë sallë për të vazhduar me nenin 36 dhe në vazhdim.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë